

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5771  
E mërkurë, 8 maj 2019  
çmimi 0.40 €

## Kosova vlerëson lart rolin e gjeneralit amerikan Timothy Orr

IFAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

Në trevjetorin e ndarjes nga jeta të Shasivar Makollit-QALIT



**ERË SHQIPËRIE** F.11

Nga: Sylejman KRASNIQI

**DHURATA HOXHA: NIVELI KOMUNAL KA NJË ROL TË RËNDËSISHËM NË PROCESET INTEGRUESE** F. 6

**PËRURORHET OBJEKTI I RI I AMBULANCEVE SPECIALISTIKE NË OKUK** F. 7

### EKONOMI

**QEVERIA VENDOS PËR NDALIMIN E PËRKOSSHËM TË EKSPORTIT TË DRURIT TË PAPËRPUNUAR** F. 9

**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR AFTËSIM PROFESIONAL TË TË RINJVE ME SINDROMËN DOWN** F. 8

### KULTURË

**VENDOSET GURTHEMELI PËR NDËRTIMIN E MUZEUT TË HISTORISË SË NATYRËS** F. 12



### SPORT

**DAUTAJ: FERIZAJ MBIJETON PA BARAZH** F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", SABRI KIÇMARI IFAQE 4-5

## Iniciativa për tribunalin ndërkombëtar për krimet serbe duhet të mbështetet

Ish-ambasadori i Kosovës në Austri dhe Australi, Sabri Kiçmari, ka thënë se iniciativa për themelimin e një tribunali ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë duhet të mbështetet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kiçmari ka treguar se për themelimin e këtij tribunali Kosovës i

duhet ndihma e miqve ndërkombëtarë. Sipas tij, për këtë qëllim është i nevojshëm krijimi i grupeve profesionale të punës me ekspertë nga fusha të ndryshme relevante, që të përgatitet një projekt serioz dhe premtues. Duke folur për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, Kiçmari ka pohuar se

marrëveshja ndërmjet dy vendeve duhet të rezultojë me njohjen e ndërsjellë. Sipas tij, marrëveshja nuk duhet bërë ngutshëm dhe shkel e shko. Ish-ambasadori Kiçmari ka theksuar se më mirë është të negociohet më gjatë sesa të arrihet një marrëveshje e shpejtë dhe e dobët

## Limaj: Qeveria do t'i mbështesë prodhuesit për të hapur vende pune

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, i shoqëruar nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka vizituar të martën fabrikën për prodhimin e veshjeve "TexCo". Limaj është ndarë i kënaqur me punën që zhvillohet në këtë fabrikë, por edhe për faktin se 95 për qind të punëtorëve në këtë fabrikë janë gra



**Haradinaj: Do të varrosen politikisht ata që ndjekin rrugën e ndryshimit të kufijve** IFAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasa, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Gjenerali amerikan Timothy Orr ka takuar në takime të veçanta përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës

## Kosova vlerëson lart rolin e gjeneralit amerikan Timothy Orr

Liderët institucionalë kanë falënderuar komandantin e Gardës Kombëtare të Iowas, gjeneralin Timothy Orr, për mbështetjen që i ka dhënë Republikës së Kosovës. Ata e kanë vlerësuar lart kontributin e tij për profesionalizmin e FSK-së, duke thënë se gjenerali Orr është një ndër personalitetet që ka ndikuar në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet ShBA-së dhe Kosovës. Kurse gjenerali amerikan ka thënë se Kosovën e ka pasur shtëpi të dytë

### "Epoka e re"

PRISHTINË, 7 MAJ - Institucionet e Kosovës kanë vlerësuar lart figurën dhe rolin e gjeneralit amerikan Timothy Orr nga Garda Kombëtare e Iowas. Në vizitën lamtumirëse në Kosovë të gjeneralit amerikan që po del në pension, krerët institucionalë e kanë cilësuar atë si një ndër personalitetet që ka ndikuar në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet ShBA-së dhe Kosovës. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se gjenerali Orr mbetet një prej mbështetësve më të mëdhenj të Republikës së Kosovës. "Gjenerali Orr me vite të tëra iu shërbeu dy popujve dhe është personifikimi më i mirë i marrëdhënieve speciale ndërmjet Kosovës dhe Iowas. Ishte gjithmonë përkrah nesh, në momentet më të veçanta për shtetin dhe popullin tonë. Edhe pas pensionimit të tij, gjenerali Orr mbetet një prej mbështetësve më të mëdhenj të Republikës së Kosovës. I jemi përjetësisht mirënjohës për kontributin e jashtëzakonshëm në modernizimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës!", ka shkruar Thaçi në

llogarinë e vet në "Facebook". Edhe gjenerali Orr është shprehur i lumtur me ngritjen e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe me bashkëpunimin e mirë ndër-shtetëror. "Kosovën e kam pasur si shtëpi të dytë", ka thënë ai, sipas komunikatës për medie të Zyrës së presidentit.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka vlerësuar se miqësia e jashtëzakonshme në mes të Kosovës dhe Iowas është trashëgimi e gjeneralit Timothy Orr. "Pata kënaqësi të madhe që ta takoj sërish sot në Prishtinë, atë dhe shumë miq nga Iowa. Gjenerali Orr po pensionohet nga Garda Kombëtare e Iowas, por ai nuk do të pensionohet kurrë nga miqësia me Kosovën. Garda të cilën e udhëhoqi është partnerja kryesore e Ushtrisë së Kosovës. Për 40 vjet shërbim në Ushtrinë amerikane, Orr është model i një qytetari e patrioti të devotshëm për sigurinë dhe paqen e vendit të tij, por dhe gjithë botës. Kosova dhe Iowa do ta forcojnë edhe më tutje partneritetin, duke marrë shembull pasionin e madh për këtë miqësi të gjeneralit Orr", ka shkruar Veseli në profilin e



tij në "Facebook".

E gjenerali Timothy Orr, sipas komunikatës për medie të Kuvendit, ka deklaruar edhe një herë përkrahjen për Kosovën. "Jam i nderuar ta takoj kryeparlamentarin Veseli dhe ta falënderoj për përkrahjen e tij për këtë marrëdhënie të veçantë mes shtetit të Iowas dhe Republikës së Kosovës. Angazhimi i tij demonstroi përkushtimin e Kosovës për zgjerimin e partneritetit ndërmjet sektorëve kritikë që përfshijnë edukimin, biznesin dhe agrikulturën, në mënyrë që të forcohet bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka theksuar gjenerali Orr. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka shkruar se partneriteti i ngushtë i Kosovës me shtetin e Iowas është reflektim i marrëdhënieve të çmuara Kosovë - ShBA.

Në profilin e tij në "Facebook", ai ka shkruar se Kosova është shtëpia e dytë për gjeneralin amerikan. "Partneriteti i ngushtë i Kosovës me shtetin e Iowas është reflektim i marrëdhënieve të çmuara që kemi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për këtë merita të jashtëzakonshme ka komandanti i Gardës Kombëtare të Iowas, gjenerali Timothy Orr, që për tetë vjet ka qenë urë e fuqishme lidhëse për avancimin e bashkëpunimit të gjithanshëm ndërmjet dy vendeve tona, posaçërisht në fushën e mbrojtjes. Gjenerali Orr, me miqësinë e tij të dëshmuar për vendin tonë, ka siguruar vendin e nderit në kujtesën shtetërore të Kosovës. Kosova do të jetë përjetë shtëpia e dytë e tij. Faleminderit gjeneral!", ka shkruar Haradinaj. Timothy Orr, sipas një komu-

nikate të lëshuar nga Zyra e kryeministrit, ka falënderuar Haradinajn për mbështetjen e ofruar në raportet speciale ndërmjet Iowas dhe Kosovës. "Kryeministri Haradinaj erdhi edhe personalisht për vizitë në Iowa për ta parë punën dinamike që po bëhet, për vazhdimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit mes popullit të Iowas dhe popullit të Kosovës", citon komunikata gjeneralin amerikan. Në shenjë respekti për angazhimin ndaj Kosovës, kryeministri Haradinaj i ka dhuruar komandantit të Gardës Kombëtare të Iowas, gjeneralmajor Timothy Orr, një Koleksion Artizanal të Armëve të Vjetra Shqiptare të punuara në Kosovë. Në përbërje të delegacionit të Iowas, të kryesuar nga gjenerali amerikan, kanë qenë edhe disa profesorë të Universitetit të Iowas.

## Thaçi anulon Samitin e BERZh-it për shkak të marrëdhënieve me Bosnjën

PRISHTINË, 7 MAJ - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, përfundimisht ka hequr dorë nga pjesëmarrja në samitin e thirrur në Sarajevë, në kuadër të takimit vjetor të Bordit të Guvernatorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Presidenti Thaçi ka falënderuar BERZh-in për ftesën dhe trajtimin e barabartë të Kosovës në këtë takim si dhe ka shprehur keqardhje për mospjesëmarrjen e tij. "Arsyeja e vetme që ka çuar te

mospjesëmarrja e presidentit Thaçi në këtë takim të nivelit të lartë janë marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bosnjës e Hercegovinës, të cilat janë në nivelin më të ulët të mundshëm", thuhet në njoftim. "Me gjithë vullnetin politik dhe gatishmërinë tonë shtetërore që të kemi marrëdhënie të mira fqinjësore me Bosnjë e Hercegovinën dhe njohje reciproke, fatkeqësisht deri më sot ky vullnet jo vetëm që nuk është pranuar, por shpeshherë edhe është keqpërdorur.

Bosnjë e Hercegovina ende nuk e ka njohur Republikën e Kosovës edhe për fatin e keq të qytetarëve të të dy vendeve. Ky shtet ende e mban në fuqi regjimin e vizave për shtetasit e Republikës së Kosovës", thuhet në njoftim. Në komunikatë thuhet se është paradoksale një situatë e tillë ku, pavarësisht luftës së përgjakshme që ka ndodhur dhe pavarësisht që ende nuk kemi një marrëveshje për normalizim, lëvizja e lirë pa pasaporta dhe pa viza funksionon ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,

derisa në anën tjetër Bosnjë e Hercegovina vazhdon t'i diskriminojë qytetarët e Kosovës me regjim të vizave. "Ne nuk mund të kuptojmë se si Bosnjë e Hercegovina aplikon dhe sillt në këtë mënyrë tërësisht antievropiane dhe më të vrazhdë se vetë Serbia. Kosova mbetet e përkushtuar për fqinjësi të mirë, bashkëpunim rajonal dhe të ardhme euroatlantike, mirëpo nuk pranon të nënshtrohet dhe të diskriminohet nga askush", thuhet në reagimin e Presidencës.



Kryeministri Ramush Haradinaj ka mbajtur konferencë për medie pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës

# Haradinaj: Do të varrosen politikisht ata që ndjekin rrugën e ndryshimit të kufijve

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se nuk mund të lëvizim më kufijtë në Ballkan sepse kjo kohë ka përfunduar. Ai ka deklaruar se do të varrosen keq politikisht ata që shkojnë rrugës së ndryshimit të kufijve. Këto komente kryeministri Haradinaj i ka bërë në një konferencë me gazetarë, duke i komentuar deklaratat e zyrtarëve serbë, se i mbeten besnikë idesë se "kufi mes shqiptarëve dhe serbëve duhet të jetë lumi Ibër"

**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 7 MAJ** - Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë të martën se ka përfunduar koha e lëvizjes së kufijve në Ballkan. Ai ka deklaruar se do të varrosen keq politikisht ata që ndjekin rrugën e ndryshimit të kufijve. "Ideja e kufijve e Aleksandar Vuçiqit dhe e Ivica Daçiçit dhe e kujtdo qoftë është që një shekull. Që një shekull serbët gatuajnë në kuzhinat e veta ide për ndarje të tokave shqiptare. Është një brez tjetër dhe besoj se ata e kanë marrë vesh se nuk mund t'i ndajë më askush tokat e shqiptarëve. Ata mund të bëjnë fqinjësi me shqiptarët nëse duan, por nuk mund t'i lëvizim më kufijtë në Ballkan sepse kjo kohë ka përfunduar. Do të varrosen keq politikisht krejt ata që shkojnë kësaj rruge, rrugës së ndryshimit të kufijve", është shprehur Haradinaj në një konferencë për medie duke e komentuar deklaratën e ministrit të Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Daçiç, që ka thënë se i mbeten besnikë idesë se "kufi mes shqiptarëve dhe serbëve duhet të jetë lumi Ibër".

Në konferencën me gazetarë kryeministri Haradinaj ka folur edhe për vizitën e gjeneralit amerikan Timothy Orr në Kosovë, me ç'rast ka thënë se marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të

Amerikës (ShBA) nuk kanë qenë asnjëherë më të mira. "Ne asnjëherë nuk kemi pasur lëkundje në marrëdhëniet me Amerikën. Vendimi i gjeneralit Timothy Orr për ardhjen në Kosovë është çështje kohe. Kemi qenë në këtë sallë kur kam thënë se marrëdhëniet me Amerikën nuk do të dobësohen, por do të forcohen. Marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Amerikës nuk kanë qenë asnjëherë më të mira në historinë e marrëdhënieve Kosovë - ShBA. Ne punojmë dhe bashkëpunojmë në fushën e sigurisë, ekonomisë, politikës dhe të tjera. Gjenerali Orr është vërtet një mik i Kosovës. Ai që tetë vjet është në shërbim të bilaterales Kosovë - Gardë Kombëtare e Iowas në përkrahje të FSK-së, por jo vetëm FSK-së", ka deklaruar Haradinaj.

Ndërsa Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka marrë vendim për vazhdimin e mandatit të Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë. Po ashtu, me vendim të kabinetit qeveritar janë ndarë mjete në vlerë prej 57 944 eurosh për pagesën e punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta në rezidencën presidenciale "Ibrahim Rugova".

Miratimin e qeverisë e ka marrë edhe vendimi për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës së Komunitetit të Istogut për shpronësim për interes publik të objekteve të



vetruara që janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit të cilat preken nga realizimi i projektit "Rregullimi i Qendrës së Qytetit në Istog" konform Planit Zhvillimor Komunal 2018-2026.

Aprovimin e kabinetit qeveritar e kanë marrë edhe nismat për lidhjen e marrëveshjes dypalëshe për qarkullimin ndërkufitar të mbeturinave, respektivisht eksportin dhe importin e mbeturinave me Republikën Federale të Gjermanisë dhe Republikën e Kroacisë.

Gjithashtu, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konceptdokumentin për politikën: Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë që kanë

diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe.

Qëllimi i këtij konceptdokumenti është që të propozojë një zgjidhje për rregullimin e çështjes së arsimit në gjuhën serbe që do t'ua mundësojë shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe që të aplikojnë për punësim dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale dhe për çështje të tjera për të cilat është e nevojshme për integrim social si dhe ta shqyrtojnë gjendjen e përgjithshme të institucion-

eve në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhën serbe.

Qeveria ka emëruar Drin Haraçinë drejtor të Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Para kabinetit qeveritar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka prezantuar raportin për funksionimin e kuvendeve të komunave për periudhën janar-mars 2019. Ky raport ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore për nivelin e funksionimit të organeve vendimmarrëse të komunave në të cilin janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës.

## Heroi Bahri Fazliu nderohet me medaljen e "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu"

**PODUJEVË, 7 MAJ (ER)** - Në 21-vjetorin e rënies së heroit Bahri Fazliu, kryeministri Ramush Haradinaj e ka nderuar atë me medaljen "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu". Vëllait të dëshmorit medaljen ia ka dorëzuar të martën Besnik Tahiri, këshilltar i kryeministrit dhe Koordinator Nacional për Reforma Shtetërore. "Në emër të kryemi-

nistrit Ramush Haradinaj i dorëzova vëllait të dëshmorëve, Fadil Fazliu, medaljen 'Gjergj Kastrioti-Skënderbeu'. Jeta dhe vepra e Bahri Fazliut është pa dyshim shembull dhe frymëzim për lirinë dhe atdheun. Bahriu, ashtu sikurse e thotë në pendën e tij, nuk u nda nga lufta, jo që nuk njohu dhimbjen dhe dashurinë për jetën, por se nuk u

pajtua me robërinë. Bahriu ra në pranverën që e deshi aq shumë, për t'i dhënë sinonim të vërtetë paqes që e frymëzonte dhe për të shtrenjtën tonë liri", ka thënë Tahiri. Ai ka theksuar se Bahri Fazliu e deshi jetën, por më shumë lirinë. "Bahri Fazliu për brezat mbetet frymëzim për jetën dhe udhërrëfyes për atdheun", ka thënë Tahiri.



Flet për "Epokën e re", Sabri Kiçmari

# Iniciativa për tribunalin ndërkombëtar



Ish-ambasadori i Kosovës në Austri dhe Australi, Sabri Kiçmari, ka thënë se iniciativa për themelimin e një tribunali ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë duhet të mbështetet. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kiçmari ka treguar se për themelimin e këtij tribunali Kosovës i duhet ndihma e miqve ndërkombëtarë. Sipas tij, për këtë qëllim është i nevojshëm krijimi i grupeve profesionale të punës me ekspertë nga fusha të ndryshme relevante, që të përgatitet një projekt serioz dhe premtues. Duke folur për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, Kiçmari ka pohuar se marrëveshja ndërmjet dy vendeve duhet të rezultojë me njohjen e ndërsjellë. Sipas tij, marrëveshja nuk duhet bërë ngutshëm dhe shkel e shko. Ish-ambasadori Kiçmari ka theksuar se më mirë është të negociohet më gjatë sesa të arrihet një marrëveshje e shpejtë dhe e dobët

ndërsjellë. Por, marrëveshja nuk duhet bërë ngutshëm dhe shkel e shko. Më mirë është të negociohet më gjatë sesa të arrihet një marrëveshje e shpejtë dhe e dobët, e cila nuk implementohet ose shkakton probleme, në vend që t'i zgjidhë ato", është shprehur Kiçmari.

**"Epoka e re":** Z. Kiçmari, sapo keni themeluar Institutin për Politikë të Jashtme të Kosovës. Çfarë ju shtyri ta themeloni këtë institut?

**Kiçmari:** Së bashku me një numër profesorësh dhe studiuesish të politikës së jashtme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare erdhëm në përfundim se politikës sonë të jashtme i mungon analiza shkencore. Ekspertët e politikës së jashtme janë vëzhgues të zhvillimeve, por nuk e kishin një forum në të cilin mund t'i shprehin pikëpamjet e veta për politikën tonë të jashtme, për zhvillimet ndërkombëtare dhe për diplomacinë. Vendi ynë po kalon zhvillime tepër dramatike në fushën e politikës së jashtme. Mendojmë se është detyrë e studiuesve ta thonë mendimin e tyre në rrafshin shkencor në lidhje me këto zhvillime.

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 7 MAJ** - Ish-ambasadori i Kosovës në Austri dhe Australi, Sabri Kiçmari, i ka dhënë mbështetje iniciativës për themelimin e një gjykate ndërkombëtare për krimet serbe në Kosovë. Profesori universitar ka thënë se kjo iniciativë, ndonëse është e vonuar, duhet të mbështetet.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se trajtimi i krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë është një obligim. "Është një iniciativë e vonuar, por që duhet mbështetur. Në fakt, Kosova ka dështuar në trajtimin me seri-

ozitet dhe kompetencë për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Kam përshtypjen se është neglizhuar një gjë e tillë. Ata që e kanë udhëhequr sistemin tonë të drejtësisë janë përgjegjës kryesorë që nuk është bërë një gjë e tillë. Trajtimi i krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë është një obligim. Ata që kanë kryer krime duhet të identifikohen, arrestohen, gjykohen dhe dënohen", ka thënë Kiçmari. A ka treguar se për ta bërë realitet një tribunal të tillë, Kosovës i duhet ndihma e miqve ndërkombëtarë. "Vendet tona mike, sidomos ShBA-ja, vendet e BE-së, Australia, Japonia, Kanada, Zelanda e Re dhe vendet e tjera demokratike, mund të

jenë mbështetëse të kësaj iniciative. Ka nevojë për krijimin e grupeve profesionale të punës, me ekspertë nga fusha të ndryshme relevante, që të përgatitet një projekt serioz dhe premtues", është shprehur ai, duke shtuar se varrezat masive në Kosovë dhe Serbi, masakrat e ndryshme dhe dhunimet, janë lehtë për t'u dëshmuar. Sipas tij, nëse bashkësia ndërkombëtare nuk e përkrah një tribunal të tillë, atëherë Kosova duhet të procedojë vetë një gjykatë speciale për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. "Nevojitet akt vendim-marrjeje institucionale, përzgjedhje kadrovike, ndarje buxhetore dhe punë profesionale e ekipore për të arritur sukses. Në

rast se aktorët ndërkombëtarë nuk pajtohen, askush nuk e pengon Kosovën ta procedojë vetë një gjykatë speciale për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Në Izrael, Gjermani dhe vende të tjera, edhe pas disa deceniesh, janë vënë para drejtësisë ata që kanë kryer krime gjatë Luftës së Dytë Botërore. Krimi gjatë luftës nuk duhet harruar", ka thënë ai. Kiçmari ka folur edhe për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se marrëveshja përfundimtare në mes të dy shteteve nuk duhet bërë ngutshëm dhe shkel e shko. "Marrëveshja në mes të dy vendeve duhet të arrihet në interes të paqes dhe marrëdhënieve bilaterale. Ajo duhet të rezultojë me njohjen e

# për krimet serbe duhet të mbështetet

interes të komunikojnë dhe zgjidhin problemet që ekzistojnë mes tyre. Dialogu në marrëdhëniet në mes të vendeve fqinje është rrugë racionale dhe e logjikshme. Por, në dialog janë bërë disa gabime themelore: Gjykata Kushtetuese, me të drejtë, hodhi poshtë marrëveshjen për asociacionin e komunave me shumicë serbe, fusnota ishte një kompromis absurd, kurse që nga vera e vitit të kaluar u hodh në diskutim publik mundësia e shkëmbimit të territoreve, e cila u shpreh me fraza të ndryshme politike. Shqetësuese është gjuha tregtare, përmes së cilës u operua në rrafshin publik: Vuçiqi arsyetohej se "Kosova nuk mund të fitojë gjithçka e Serbia asgjë", kurse te ne dikush fliste për "dhuratën e Rankoviçit". Kjo nuk është gjuhë politike. Nëse lexohen me kujdes të dyja këto fraza, prapa tyre fshihet logjika tregtare, duke e konsideruar territorin si mall, të cilin duhet fituar, ose si dhuratë, të cilën duhet refuzuar. Marrëveshja në mes të dy vendeve duhet të arrihet në interes të paqes dhe marrëdhënieve bilaterale. Ajo duhet të rezultojë me njohjen e ndërsjellë. Por, marrëveshja nuk duhet bërë ngutshëm dhe shkel e shko. Më mirë është të negociohet më gjatë sesa të arrihet një marrëveshje e shpejtë dhe e dobët, e cila nuk implementohet ose shkakton probleme, në vend se t'i zgjidhë.

**"Epoka e re":** Samiti i Berlinit duket se fazës finale të dialogut Kosovë - Serbi i ka dhënë një kah tjetër. Tani të gjithë sytë i kanë kthyer kah Samiti i Parisit, në të cilin do të diskutohet vetëm për këtë proces. Cilat janë pritje e juaja nga ky samit?

**Kiçmari:** Në Samitin e Berlinit të dyja palët kanë marrë mesazhin e rëndësishëm që ka pajtimi dhe gjetja e një marrëveshjeje në mes të dy vendeve për të ardhmen e tyre në BE. Kancelarja Merkel dhe presidenti Macron ua kanë ofruar palëve përvojën gjermano-franceze dhe, bazuar në këtë përvojë, u munduan t'i joshin me përfitimet që ka për Kosovën, Serbinë dhe vendet e rajonit nga një marrëveshje eventuale në mes të dy vendeve. Takimi i sotëm i kancelares Merkel me sekretarin e Shtetit të ShBA-së është shumë me rëndësi për dakordimin e hapave që duhen ndërmarrë. Është një zhvillim që përputhet me strategjinë diplomatike të aktorëve tanë, që gjithçka të jetë në pajtim edhe me aleatin tonë strategjik - ShBA-në. Samiti i Parisit pritet të jetë më konkret. Në të do të debatohet për hapat drejt zgjidhjes. Mund të supozojmë një ashpërsi të gjuhës, të asaj që në diplomaci quhet si vënia

para shkopit dhe karotës: nëse pranoni këtë veprim, do të keni këto përfitime; në rast refuzimi, do t'i keni këto pasoja. Megjithatë, është ende herët të flitet për detajet. Shumica do të qartësohet në javët që vijnë.

**"Epoka e re":** Kryeparlamentari Kadri Veseli tani ka marrë një iniciativë për themelimin e një tribunali ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Si e keni parë këtë iniciativë?

**Kiçmari:** Është një iniciativë e vonuar, por që duhet mbështetur. Në fakt, Kosova ka dështuar në trajtimin me seriozitet dhe kompetencë për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Kam përshtypjen se është neglizhuar një gjë e tillë. Ata që kanë udhëhequr sistemin tonë të drejtësisë janë përgjegjës krye-

sorë që nuk është bërë një gjë e tillë. Trajtimi i krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë është një obligim. Ata që kanë kryer krimet duhet të identifikohen, arrestohen, gjykojnë dhe dënohen.

**"Epoka e re":** Cilat janë gjasat që ky tribunal të bëhet realitet, dhe kush mund ta ndihmojë Kosovën në këtë drejtim?

**Kiçmari:** Vendet tona mike, sidomos ShBA-ja, vendet e BE-së, Australia, Japonia, Kanada, Zelanda e Re dhe vende të tjera demokratike, mund të jenë mbështetëse të kësaj iniciative. Ka nevojë për krijimin e grupeve profesionale të punës, me ekspertë nga fusha të ndryshme relevante, që të përgatitet një projekt serioz dhe premtues. Varrezat masive në Kosovë, varrezat masive të gjetura dhe

ende të pagjetura në Serbi, masakra e Prekazit, e Reçakut dhe një numër masakrash të tjera, rasti i Ukshin Hotit, Xhavit Hazirit, Fehmi Aganit, Bajram Kelmendit dhe shumë raste të tjera, dhunimi i rreth 20 000 femrave, janë lehtë për t'u dëshmuar. Nevojitet akt vendimmarrjeje institucionale, përzgjedhje kadrovike, ndarje buxhetore dhe punë profesionale e ekipore për të arritur sukses. Në rast se aktorët ndërkombëtarë nuk pajtohen, askush nuk e pengon Kosovën ta procedojë vetë një gjykatë speciale për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Në Izrael, Gjermani dhe vende të tjera, edhe pas disa deceniesh, janë vënë para drejtësisë ata që kanë kryer krimet gjatë Luftës së Dytë Botërore. Krimi gjatë luftës nuk duhet harruar.



## Pas rasteve të dhunës në shkolla, kërkohet shtimi i patrullave policore

Prishtinë, 7 maj (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në kuadër të angazhimeve për gjetjen e një zgjidhjeje për shtimin e sigurisë në shkolla, ka pritur të martën në takim ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, me bashkëpunëtorë, drejtorin e Operacioneve në Policinë e Kosovës, Afrim Ahmeti dhe zëvendëskryetarin e Kolegjiut të Drejtorive Komunale të Arsimit, Blerim Thaqi.

Ministri Bytyqi, pas diskutimeve në lidhje me aktet e dhunës në shkolla, të raportuara kohën e fundit, ka kërkuar

bashkëpunimin e të gjithë aktorëve relevantë të pranishëm në takim, me të cilët edhe janë arritur marrëveshje të cilat do të çojnë drejt një zgjidhjeje të përshtatshme për eliminimin e kësaj dukurie.

Pas diskutimeve rreth marrjes së përgjegjësisë nga përfaqësuesit e institucioneve të arsimit dhe sigurisë, të pranishmit në takim kanë ardhur në përfundim që zgjidhje afatshkurtër deri në përfundim të vitit shkolor të jetë shtimi i patrullave policore në shkolla dhe hartimi i planit për kontroll rutinor të nxënësve nga drejtorët e shkollave, për të cilin plan poli-

cia duhet të njoftohet përmes DKA-ve.

Ministri Bytyqi, ministri Mustafa, përfaqësuesi i Policisë dhe ai i Kolegjiut të DKA-ve, po ashtu, u pajtuan që pas përfundimit të vitit shkollor të bëhet krijimi i Task Forcës për parandalimin e përdorimit të narkotikëve dhe shtimin e sigurisë në shkolla. Në këtë takim ministri Bytyqi i ka ftuar drejtoritë komunale të arsimit që të kërkojnë nga drejtorët e shkollave të mbajnë mbledhje urgjente me prindër për të diskutuar sigurinë në shkolla dhe planet për ta përmirësuar atë.

**"Epoka e re":** Në këtë muaj keni paraparë edhe organizimin e një konference shkencore. Cili është qëllimi i saj?

**Kiçmari:** Konferenca "Politika e jashtme e Kosovës në këndvështrim shkencor" do të mbahet më 23 maj. Në të do të analizohen sfidat e Kosovës në procesin e shtetndërtimit dhe refleksionet e tyre në politikën e jashtme, raportet e Kosovës me shtetet e tjera, procesi i njohjes dhe vështirësitë me të cilat po përballon Republika e Kosovës në këtë proces, dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, procesi i integritetit të Republikës së Kosovës në BE, NATO dhe organizata ndërkombëtare etj. Përmes një debati të mirëfillt shkencor do t'i shqyrtojmë mundësitë, interesat, qëllimet dhe mjetet e politikës së jashtme të Kosovës dhe do të propozojmë edhe rrugë konkrete për realizimin e tyre.

**"Epoka e re":** Dialogu me Serbinë mbetet një prej sfidave kryesore të politikës së jashtme të Kosovës. A po veprojnë institucionet e Kosovës si duhet në raport me këtë proces?

**Kiçmari:** Kosova dhe Serbia janë vende fqinje. Të dy vendet kanë

## Dhurata Hoxha: Niveli komunal ka një rol të rëndësishëm në proceset integruese

Në kuadër të Ditës së Evropës, Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka qëndruar të martën në Komunën e Kamenicës, ku temë diskutimi ka qenë "Promovimi i vlerave të BE-së, rëndësia e gjithëpërfshirjes në procesin integrues". Ministria Hoxha ka theksuar se niveli komunal ka një rol të rëndësishëm në proceset integruese



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 MAJ - Në kuadër të Ditës së Evropës, Ministria e Integritimit Evropian ka organizuar diskutim me të rinjtë e Komunës së Kamenicës, ku e pranishme ka qenë edhe ministria Dhurata Hoxha, kryetari i Kamenicës Qëndron Kastrati, ambasadorja e Suedisë në Kosovë, Karin Hermarck Ahliny, Diellza Mujaj, bursiste e Young Cell Scheme dhe studentë e nxënës nga kjo komunë. Temë e diskutimit ka qenë "Promovimi i vlerave të BE-së, rëndësia e gjithëpërfshirjes në procesin integrues". Komuna e Kamenicës me barazinë në kuadër të strukturave udhëheqëse ka vendosur një standard të mirë për barazinë gjinore, prandaj është zgjedhur për të

diskutuar promovimin e vlerave të BE-së në qendër të të cilave është gjithëpërfshirja. "Integritimi në BE paraqet mundësi, sfidë dhe avancim për arritjen e objektivave kyçe të BE-së dhe për përfaqimin e vlerave të cilat ajo i përfaqëson", ka deklaruar ministria Hoxha, duke shtuar se niveli komunal ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në proceset integruese. Sipas saj, anëtarësimi në BE sjell përfitime të mëdha për Kosovën në fusha si avancimi i të drejtave dhe

lirive të barabarta, zhvillimi ekonomik si dhe në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. "Ne po realizojmë reformat në fusha si sundimi i ligjit dhe zhvillim ekonomik", ka theksuar Hoxha, duke shtuar se sfidë është papunësia e të rinjve dhe grave, përkundër rritjes më të madhe ekonomike në rajon. Ajo ka thënë se po bëhet përpjekje për cilësinë e arsimit, promovimin e zhvillimit ekonomik me inovacion dhe ndërmarrësi si dhe për avancimin e kuadrit, ku qindra

studentë nga Kosova - nëpërmjet Young Cell Scheme - studiojnë në universitetet evropiane. Kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka shprehur angazhimin dhe përkushtimin e tij në komunë për zbatimin e ligjit, për vlerat e barazisë dhe përfshirjen e komuniteteve. Ai ka thënë se vlerat dhe parimet që vlejnjë në BE duhet t'i zbatohet për hir të qytetarëve, për veten tonë, sepse janë arritje e pranuar dhe kjo do të jetë më e mira për Republikën e Kosovës.

Kurse ambasadorja e Suedisë në Kosovë, Karin Hermarck Ahliny, ka folur për rëndësinë e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjen, duke vënë në dukje përvojat nga Suedia si model i demokracisë dhe për zbatimin e barazisë. Ndërsa bursistja Diellza Muja ka vlerësuar lart arsimimin në universitetet më të mira të Evropës, skemën Young Cell si rast i mirë për të rinjtë që të jenë të dobishëm dhe të aftë për t'i çuar përpara agjendat tona evropiane.

## Mustafa takohet me O'Connellin, thotë se situata në vend është ndërlikuar

PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, të martën ka pritur në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell. Gjatë këtij takimi është biseduar për zhvillimet aktuale në Kosovë dhe për qëndrimet e LDK-së në lidhje me zhvillimet e fundit. Kryetari Mustafa ka vlerësuar se gjendja aktuale politike në vend është mjaft e ndërlikuar dhe kërkon angazhim serioz dhe

kreativ të të gjithë aktorëve politikë për ta garantuar mbrojtjen e interesave shtetërore të Kosovës. Duke e falënderuar për mbështetjen e pazëvendësueshme të Britanisë për Kosovën, kryetari Mustafa ka shprehur përkushtimin e LDK-së dhe të qytetarëve të vendit i për ta thelluar bashkëpunimin edhe më tutje. Ndërsa ambasadori O'Connell ka falënderuar kryetarin Mustafa për pritjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm.



## Betohen 12 prokurorë të rinj

PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Para presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të martën janë betuar solemnisht 12 prokurorë me mandat fillestar. Prokurorët e

rinj janë betuar se gjatë kryerjes së detyrave do t'i qëndrojnë kurdoherë besnikë Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe do t'i

respektojnë rregullat e etikës profesionale. Këta prokurorë të rinj do të shpërndahen nëpër të gjitha prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës.



# Përurohët objekti i ri i ambulancave specialistike në QKUK

Të martën është përruar objekti modern i ambulancave specialistike në QKUK prej 2 500 metrash katrorë, i pajisur me aparaturën më moderne. Ky objekt tashmë është i gatshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dinjitoze deri në 900 pacientë në ditë

**EPOKA  
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili dhe drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, dr. Basri Sejdiu, kanë përruar të martën objektin e

ri të ambulancave specialistike në QKUK.

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se ndryshimet rrënjësore që po ndodhin në shëndetësinë e Kosovës janë më se të dukshme. "Për shumë vjet qytetarët kanë marrë shërbime specialistike nëpër bodrume të QKUK-së, në kushte aspak të dinjitetshme dhe me pritje të



gjata. Të gjitha këto kanë marrë fund. Objekti modern i ambulancave specialistike prej 2 500 metrash katrorë, i pajisur me të gjithë infrastrukturën përcjellëse për ofrimin e shërbimeve dinjitoze për qytetarët, është një hap i rëndësishëm në kuadër të reformave që po ndërmarrim", është shprehur Veseli.

Ai ka përgëzuar ministrin Uran

Ismaili për përkushtimin dhe punën e jashtëzakonshme për transformimin e një ndër sektorëve më delikatë të shërbimeve publike në Kosovë. Edhe ministri Uran Ismaili ka thënë se është jashtëzakonisht i lumtur që pas një pune shumë të madhe, sot po përurohët objekti i ri i ambulancave specialistike, siç ka thënë ai, për të lënë mbrapa të

kaluarën e hidhur të shërbimeve mjekësore nëpër bodrume.

Ismaili ka shtuar se objekti modern prej 2 500 metrash katrorë është i pajisur me aparaturën më moderne. "Tashmë është i gatshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dinjitoze për 900 pacientë në ditë", ka thënë ministri Ismaili.

## Vendoset gurthemeli për ndërtimin e muzeut të historisë së natyrës



PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, bashkë me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kanë vendosur gurthemelin e muzeut të historisë së natyrës në parkun "Te Pishat" në Sllatinë.

Ministri Gashi ka thënë se ky muze do të shërbejë për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e koleksioneve të natyrës së Kosovës si dhe do të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës promovuese dhe edukative të ndërlidhur me trashëgiminë kul-

ture. "Ky projekt e përmirëson edukimin dhe ndihmon zhvillimin shkencor edhe për popullatën vendëse", ka thënë Gashi. Ministri Gashi ka thënë se ndërtimi i muzeut të historisë së natyrës ka për qëllim koleksionimin, ekspozimin dhe arkivimin e mbetjeve të çfarëdo organizmi në standardet më të larta të mundshme për ta siguruar ruajtjen dhe të gjitha informatat rreth tyre. "Ky institucion i ri do të ketë karakter vetëdijësues dhe edukativ për natyrën dhe do të jetë përgjegjës edhe për zhvillimin e

hulumtimeve, për interpretimin e rezultateve, për përkrahjen e proceseve të shkencës dhe konservimit biologjik", ka thënë Gashi, duke sqaruar se muzeu do të jetë qendër hulumtimi, studimi dhe trajnimi për muzeologji dhe fusha të tjera relevante në raport me historinë e natyrës dhe qendër e kultivimit të trashëgimisë etno-botanike.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se muzeu i natyrës do të jetë një pasurim i koleksionit të pasur që ka natyra.

## Maloku nderohët me medaljen e "Gjergj Kastriotit-Skënderbeut" dhe emërohet këshilltar i Haradinajt

Prishtinë, 7 maj (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim eprorin e UÇK-së, Naim Malokun, të cilit në shenjë mirënjohje i ka ndarë medaljen e "Gjergj Kastriotit-Skënderbeut"

si dhe e ka emëruar këshilltar të vetin politik. "Kënaqësi ta prisja këtë mëngjes veprimtarin e hershëm të çështjes shqiptare, eprorin e UÇK-së dhe bashkëpunëtorin tim të afërt. Naim Maloku një jetë qëndroi në

shërbim të Kosovës. Në shenjë mirënjohje i kam dhuruar medaljen e 'Gjergj Kastriotit-Skënderbeut' dhe, po ashtu, pata nderin ta emëroj këshilltar politik", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



# Limaj: Qeveria do t'i mbështesë prodhuesit për të hapur vende të punës



Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, i shoqëruar nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka vizituar të martën fabrikën për prodhimin e veshjeve "TexCo". Limaj është ndarë i kënaqur me punën që zhvillohet në këtë fabrikë, por edhe për faktin se 95 për qind e punëtorëve në këtë fabrikë janë gra

PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, i shoqëruar nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka vizituar të martën fabrikën për prodhimin e veshjeve "TexCo". Limaj është ndarë i kënaqur me punën që zhvillohet në këtë fabrikë, por edhe për faktin se 95 për qind e

punëtorëve në këtë fabrikë janë gra. Prodhimet e kësaj fabrike kanë destinacion tregjet ndërkombëtare dhe kjo, sipas Limajt, dëshmon se edhe në Kosovë mund të prodhohet tekstil dhe prodhime të tjera me kualitet të lartë. "Krejt ky prodhim që bëhet në këtë fabrikë është për

eksport. Kjo tregon që me një angazhim të përbashkët, me krijimin e klimës për investime dhe me mbështetjen që duhet t'i jepet biznesit, mundësitë për zhvillim janë të mëdha në vendin tonë. Janë dhjetëra fabrika në Kosovë të cilat po depërtojnë në tregjet botërore", ka thënë Limaj. Ai është zotuar se Qeveria

e Kosovës do të mbështesë me politika fiskale për të mundësuar sa më shumë investitorë dhe për të mundësuar punësime më shumë të njerëzve.

Më tutje, Limaj ka thënë se pronari i kësaj kompanie është jashtëzakonisht i kënaqur me punën e punonjësve të kësaj fabrike "Punonjëset e kësaj fabrike po tregojnë përkushtim në punë, po mësojnë shpejt dhe, siç e tha edhe pronari, punën që e bëjnë ato është vështirë të bëhet diku tjetër nga duart e tyre të vyera", ka shtuar Limaj.

Ndërsa ministri i Tregtisë dhe

Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se prodhimet e saj kjo kompani i eksporton në shtetet e Bashkimit Evropian, e që këto produkte shiten me etiketën Republika e Kosovës. "Ne si Qeveri e Kosovës jemi të përkushtuar t'u dalim në ndihmë bizneseve me aftësimin e punëtorëve që të jenë sa më të konkurrueshëm", ka thënë Shala. Edhe pronari i kësaj fabrike, Yusuf Eldelekiloglu, është ndarë i kënaqur me punën në këtë fabrikë. Ai ka thënë se brenda një periudhe të shkurtër synojnë ta dyfishojnë numrin e punëtorëve.

## Nënshkruhet marrëveshja për aftësim profesional të të rinjve me sindromën Down

PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Shoqata "Down Syndrome Kosova" kanë nënshkruar të martën marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim të aftësimin profesional të të rinjve me sindromën Down, në kuadër të implementimit të projektit "Promovimi i Aftësive për Punësim të Personave me sindromë Down në Kosovë". Marrëveshja është nënshkruar nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica dhe drejtoresha ekzekutive e Shoqatës "Down Syndrome Kosova", Sebahate Beqiri. Ministri Reçica ka thënë se MPMS-ja në vazhdimësi është e përkushtuar për ofrimin e

mundësive për punësim dhe aftësim profesional për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Drejtoresha Beqiri ka shprehur falënderimet për mbështetjen që MPMS-ja po ua jep të rinjve të shoqatës në mënyrë që të kenë qasje në aftësim profesional, duke theksuar se aftësimi profesional i të rinjve me sindromën Down është shumë i rëndësishëm. Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të MPMS-së dhe "Down Syndrome Kosova", 56 të rinj me sindromën Down do ta kenë mundësinë të ndjekin trajnim tremujor në fushën e aftësimin profesional në Qendrat e Aftësimin Profesional në Ferizaj, Gjilan, Gjakovë e Pejë.





# Qeveria vendos për ndalimin e përkohshëm të eksportit të drurit të papërpunuar

Me propozim të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të martën për ndalimin e përkohshëm të eksportit të masës drusore si lëndë e papërpunuar nga Kosova në drejtim të vendeve të tjera për arsye të dëmtimit në sektorin e përpunimit të drurit në Kosovë



**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 MAJ - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, në vazhdim të mbrojtjes së prodhuesve vendorë, ka propozuar ndalimin e eksportit të masës drusore për shkak se është duke dëmtuar rëndë sektorin e përpunimit të drurit në vendin tonë, gjithashtu lejimi i këtij aktiviteti po i rritë prerjet ilegale të pyjeve.

Shala ka propozuar këtë masë ndalimi të martën para kabinetit qeveritar duke dhënë arsyetimin. "Në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij propozimvendimi për ndalimin përkohësisht të eksportit të masës drusore si lëndë e papërpunuar nga Kosova në drejtim të vendeve të tjera, për arsye të

dëmtimit në sektorin e përpunimit të drurit në vendin tonë, shkurtimisht paraqes bazën ligjore dhe rëndësinë e këtij propozimvendimi. Masa për ndalimin përkohësisht të eksportit të masës drusore është bërë për arsye se lejimi i vazhdueshëm i eksportit të masës drusore për eksport në vendet e tjera si lëndë e papërpunuar (trupa), në një kohë kur të gjitha vendet përreth e kanë ndërprerë eksportin nga vendet e tyre, është duke dëmtuar rëndë sektorin e përpunimit të drurit në vendin tonë. Gjithashtu, lejimi i këtij aktiviteti po i rritë prerjet ilegale në Kosovë qoftë për masë drusore teknike, edhe për masën drusore dru zjarri", ka thënë Shala në mbledhjen e Qeverisë Shala. Sipas tij, kapacitetet vjetore të shfry-

tëzimit të drurit nuk i përm-bushin nevojat e vendit tonë, prandaj lejimi i eksportit e rrezikon fondin pyjor si dhe paraqet probleme të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve në Kosovë. "Prandaj, propozimi për pezullimin e përkohshëm të eksportit të masës drusore e

parandalon prerjen ilegale të pyjeve duke pasur parasysh kapacitetet e komunave për mbrojtje të pyjeve si dhe e ruan fondin pyjor në Kosovë dhe u mundëson përpunueseve të drurit furnizim më të qëndrueshëm me lëndë të parë. Ky propozimvendim është hartuar

në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011 si dhe në konsultim dhe me rekomandim të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural", ka thënë Shala.

## Nënshkruhet marrëveshja që u mundëson fermerëve të kenë çmime më të lira të derivateve të naftës

PRISHTINË, 7 MAJ (ER) - Ka filluar implementimi i marrëveshjeve të kompanisë "Shell" nëpër komunat e Republikës së Kosovës. Lajmin e kanë bërë me dije përfaqësuesit e kompanisë "Shell". Tanimë është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe kompanisë "Shell" për zbritje të çmimit të derivateve të naftës për të gjithë bujqit dhe fermerët e komunave të Kosovës për

aktivitetet e tyre bujqësore. "Të gjithë bujqit dhe fermerët mund të furnizohen në mbi 60 pika të 'Shell'-it në tërë Kosovën. Zyrtarët e kompanisë 'Shell' kanë thënë se të gjithë fermerët që ndodhen në regjistrat zyrtarë të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, do të përfitojnë çmim për 5 cent më lirë për litër sesa çmimi i tregut", është thënë në njoftimin për media të kompanisë "Shell".

## ATK-ja: Lejohen lojërat shpërblyese me para të gatshme deri në 1 000 euro

PRISHTINË, 7 MAJ - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar të gjitha subjektet, kompanitë, bizneset të cilat merren me organizimin e lojërave shpërblyese, se Ligji aktual Nr. 04/L-080 për Lojërat

e Fatit, konkretisht neni 5, paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit, nuk i trajton si lojëra fati konkurset (lojërat) shpërblyese që organizohen nga subjektet me qëllime publicitetit, me kusht që pjesëmarrja në lojë të mos

inkasohet dhe të mos ketë kosto shtesë, si dhe shpërblimet të jepen në produkte, shërbime ose në para të gatshme duke mos tejkualuar shumën prej 1 000 eurosh për person. "Në një situatë, kur Ligji aktual

mbi Lojërat e Fatit më datë 10 maj 2019 shfuqizohet me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri Nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit, pas kësaj date Administrata Tatimore nuk ka autoritet për të miratuar rreg-

ulla të lojërave shpërblyese dhe zyrtarët e saj nuk do të jenë pjesëmarrës në çfarëdo cilësie në ngjarjet e tilla që mund të organizohen në të ardhmen", është thënë në njoftimin e ATK-së.



## Komuna e Malishevës dhe Ministria e Bujqësisë koordinohen për fushatën kundër rriqrave

Malishevë, 7 maj (ER) - Në Komunën e Malishevës është zhvilluar një takim i përbashkët i Shtabit Komunal për menaxhimin e situatës nga Ethet Hemorragjike Krime Kongo (EHKK) dhe Ministrisë së Bujqësisë, si dhe operatorit që do ta bëjë dezinfektimin e zonave endemike. Ky takim kishte për qëllim koordinimin sa më të mirë për realizimin e fushatës së dezinfektimit kundër rriqrave.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili drejton Shtabin Komunal për EHKK-në, i ka njoftuar të pranishmit me masat e deritanishme që janë ndërmarrë e, po ashtu, për nevojën e koordinimit sa më të mirë për realizimin e fushatave të cilat do të prodhonin rezultat në mënyrë që të vazhdohet mbajtja në kontroll e kësaj situatë. Ndërsa zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë janë shprehur të gat-

shëm për vazhdimin e bashkëpunimit dhe koordinimin e aktiviteteve, me qëllim të arritjes së rezultateve konkrete në këtë drejtim. Edhe operatori është shprehur i gatshëm për fillimin e fushatës së dezinfektimit kundër rriqrave. Komuna e Malishevës dhe Ministria e Bujqësisë janë marrë vesh që dezinfektimi i zonave endemike të bëhet në kohë të përshtatshme atmosferike.

## Spitali i Mitrovicës dhe QKMF-ja pranojnë donacion në vlerë prej 75 mijë eurosh

MITROVICË, 7 MAJ (ER) - Afaristi shqiptar nga Gjermania, Bahri Tahiri, në bashkëpunim me doktorin gjerman, prof. dr. hc. Henrich Schantmann, kanë bërë dorëzimin e donacionit me vlerë prej 75 mijë eurosh për spitalin rajonal "Dr. Sami Haxhibeqiri" dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Nexhat Çuni" në Mitrovicë. Ky donacion përmban pajisje mjekësore, siç janë shtretër, mbuloja, karroca dhe gjëra të tjera të cilat do të shërbejnë për nevojat e këtyre objekteve spitalore. Me

këtë rast, drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani, ka falënderuar donatorin në fjalë, duke e cilësuar si shumë të rëndësishëm këtë donacion, meqenëse sektori i shëndetësisë duhet të ketë gjithmonë prioritet dhe veprimet e tilla janë për t'u përgëzuar. Gjithashtu, ajo ka theksuar se këto pajisje janë shumë të nevojshme për mbarëvajtjen e punës në sektorin e Shëndetësisë. Po ashtu, një pjesë e këtij donacioni do t'i shpërndahet edhe qytetit të Vushtrrisë, Ferizajt, Prishtinës dhe Suharekës.



## Komuna e Prizrenit lanson projektin 'Forumi i bashkinvestimit dhe rrjetëzimit', i pari i këtij lloji në nivel lokal

PRIZREN, 7 MAJ (ER) - Komuna e Prizrenit, së bashku me organizatën joqeveritare "Germin", të martën ka lansuar projektin "Forumi i bashkinvestimit dhe rrjetëzimit", i pari i këtij lloji në nivel lokal, i cili synon t'i tërheqë investimet e huaja dhe nga diaspora në qytetin e Prizrenit dhe të krijojë lidhje të reja tregtare për bizneset vendore. Në këtë lansim të organizuar në ambientet e Komunës së Prizrenit të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, përfaqësuesit e organizatës Germin, të shoqatave vendore të biznesit, Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe të Unionit të Bizneseve Shqiptare-Gjermane. Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, gjatë këtij lansimi ka shprehur vullnetin



dhe gatishmërinë e komunës për t'i promovuar investimet nga diaspora dhe investorët e tjerë të huaj. Kryetari Haskuka ka theksuar se potenciali i diasporës për investime duhet të kanalizohet në fusha që gjenerojnë punësim dhe të ardhura, e jo vetëm konsum. Ai ka falënderuar pjesëmarrësit dhe orga-

nizatën "Germin" për lehtësimin e këtij procesi si dhe ka thënë se komuna është hapur për bashkëpunim dhe mikpritje të investorëve. "Forumi i bashkinvestimeve dhe rrjetëzimit do të fokusohet në ofrimin e një pasqyre sa më të qartë për investorët e jashtëm dhe nga diaspora, si dhe për

mundësitë zhvillimore dhe biznesore që i ofron qyteti i Prizrenit. Tërheqja e kompanive të huaja dhe nga diaspora për të investuar në Prizren është një nga synimet kryesore për t'u arritur përmes këtij bashkëpunimi, siç është edhe krijimi i mundësive për t'i lidhur prodhuesit vendorë me partnerë

në tregjet e jashtme", u shpreh drejtoresha e "Germin", Liza Gashi.

Nora Hasani nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare i ka informuar pjesëmarrësit rreth trajnimeve përgatitore që kjo organizatë do t'i bëjë në Prizren gjatë muajit maj, të cilat do t'u shërbejnë bizneseve lokale për t'i zgjeruar kapacitetet biznesore. Përfitues të këtij programi/projekti do të jenë qytetarët, bizneset dhe institucionet e Komunës së Prizrenit të mandatuara për zhvillim ekonomik, si dhe kompanitë me potencial investues nga jashtë dhe nga diaspora.

Në këtë forum pritet të jenë më shumë se 40 investitorë nga diaspora, të cilët kanë shprehur interesim për të qenë bashkëkrijues për të ardhmen e Prizrenit.

## Komuna e Rahovecit renditet e dyta sa i përket 'Indeksit të konkurrueshmërisë së komunave'

RAHOVEC, 7 MAJ (ER) - Është prezantuar të martën në Prishtinë raporti "Indeksi i konkurrueshmërisë së komunave", ku janë prezantuar gjetjet e anketës me 3 350 biznese nga 38 komunat e Kosovës, gjetje këto përmes të cilave

është arritur deri te vlerësimi i qeverisjes lokale në bazë të ambientit përkrahës për zhvillim të bizneseve. Në prezantim u tha se Komuna e Rahovecit është renditur e dyta. Kjo është hera e pestë që USAID-i në Kosovë zbaton studimin e IKK-

së me qëllim të orientimit të reformave të politikave publike, bazuar në dëshmi. Kosova ka nevojë për një politikëbërje që bazohet në evidencë dhe që merren masa pastaj për përmirësimin e të bërit biznes në Kosovë", ka thënë drejtori

ekzekutiv i Institutit Riinvest, Alban Hashani.

Certifikatën për renditjen në vendin e dytë të Komunës së Rahovecit e ka pranuar Artan Asllani, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.



Mbresa nga tubimi përkujtimor në trevjetorin e ndarjes nga jeta të Shasivar Makollit-QALIT

# ERE SHQIPERIE

**Sylejman KRASNIQI**

Është bërë traditë që të përkujtohen datat me rëndësi të veçantë nga historia jonë shumë e bujshme. Përkujtohen ditët e betejave, të luftërave, të ngjarjeve me peshë, ditëlindjet e martirëve, të dëshmorëve, të heronjve. Përkujtohen edhe datat e rënies heroike të tyre, por edhe të vdekjeve të natyrshme të veprimtarëve të çështjes kombëtare sepse edhe vdekjet natyrale të tyre e kanë peshën e njëjtë sikurse të vdekjeve në fronte të luftës. Edhe këta e kanë "ndjellë" vdekjen nëpër llogore apo edhe nëpër qytete, ku kanë vepruar pa i trembur syri edhe në ditën me diell. Vdekja edhe mund t'i ketë "kursyer" këta idealistë, ndoshta, me qëllim që ta shijojnë lirinë për të cilën nuk kursyen asgjë nga vetvetja.

Një tubim përkujtimor u organizua edhe për veprimtarin e shquar të çështjes kombëtare dhe për luftëtarin e lirisë, Shasivar Makollin-QALIN, nga Organizata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 26 prill. Atë ditë, paradite, u bënë homazhe te varri i tij dhe u zbulua pllaka përkujtimore me simbolin të cilin e desh dhe për të cilin kishte punuar dhe luftuar tërë jetën. Kurse pasdite u mbajt një tubim përkujtimor në sallën e Teatrit Kombëtar të Kosovës. Në këtë akademi përkujtimore e morën fjalën shumë luftëtarë dhe veprimtarë të çështjes kombëtare, të cilët e njihnin nga afër dhe që kishin bashkëpunuar dhe bashkëluftuar me Shasivar Makollin. Me radhë e morën fjalën përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe të shoqatave të ndryshme. Të gjithë ia njohën meritat e veprimtarisë të Shasivarit në organizim, në syçeltësi, në trimëri, në vendosmëri, në këmbëngulësi dhe në çdo lëmë që kishte për strumbullar çështjen shqiptare.

Në fund, në emër të familjarëve, të pranishmit në akademi i përshëndeti vajza e Shasivarit, Merita Makolli. Fjala e saj, të pranishmëve u solli shumë emocione. Shokëve të punës të

Shasivarit, të pranishëm në sallën e teatrit, u rrodhën edhe lot nga sytë në faqe, prej fjalëve të Meritës. Sepse, Merita, e preku thelbin e karakterit të të atit, ashtu siç e njihnin shokët e punës për ato dyzet vjet sa kishin punuar bashkë në minierën e qymyrit në Bardh të Madh (ish-Bellaqevc). Brenda një fjalie ajo e tha, dhe e dha, natyrën dhe idealin e babait pa kurrfarë zbulimi. Këtë ideal ai kurrë nuk e ndryshoi, por as nuk ia "përshtati" kohës. Thelbi i fjalës së Meritës ishte "kur babai u kthye nga Shqipëria për herën e parë ne, fëmijët e tij, iu merrim erë rrobave të babait sepse atyre u vinte era Shqipëri dhe nuk ngopeshim me atë erë. Prandaj unë, këtu, në këtë sallë, uroj që brezat e ardhshëm, fëmijët tanë, të rriten me atë aromë të ëmbël që e kemi ndër ne në rrobat e babait tonë". Kjo na bëri të përlolemi sepse, jemi të sigurt që Shasivari e dha porosinë nëpërmjet gojës së vajzës së vet, Meritës, për ne dhe për brezat që vijnë. Kjo na ktheu për dyzet vjet prapa kur më 1 shtator 1980 shkuam për vizitë dyjavore në Shqipëri 30 punëtorë nga miniera e qymyrit e Bellaqevcit me nismën dhe organizimin e Shasivar Makollit. Ishte një ekskursion i cili na la përshtypje të jashtëzakonshme dhe e cila nuk mund të harrohet kurrë. Ato ditë ëndrrat tona u bënë realitet sepse kishim arritur ta vizitonim nënën Shqipëri. Dhe nuk lamë krahinë, qytet, muze, shtëpi muze, fabrikë, uzinë pa e vizituar. Emocione të veçanta patëm kur u ndalëm tek përmendorja e heroinës së punës, Shkurte Pal Vata, në hekurudhën Rrogozhinë - Fier. Kurrë nuk do t'i harrojmë fjalët që na i tha Shasivari pasi bëmë fotografi te përmendorja e Shkurte Pal Vatës. "Kur do të punojmë edhe ne, në Kosovë, për vete? Edhe ne jemi punëtorë të vyeshtëm. Tani që e kemi edhe shembullin e Shkurte Pal Vatës, të Ismet Sali Bruçajt dhe të Adem Rekës. Edhe te ne punohet shumë dhe ka sakrificat të mëdha në punë, por munda ynë shkon në Serbi dhe në pjesët e tjera të Jugosllavisë". Pse edhe tek ne mos të ketë hero të punës, thoshte shpesh Shasivari, kur edhe ne po ngrehim fabrika,



Në foto: Obelisku i heroinës së punës socialiste, Shkurte Pal Vata, në trasenë e hekurudhës Rrogozhinë - Fier. Fotografuar më 5 shtator 1980. Ulur, me grushtin lart, Shasivar Makolli; në këmbë, anash, vëllezërit Ibrahim dhe Ismail Maxhera nga Bellaqevci, në mes Ramiz Shehu nga Tirana, ish-drejtor i "Albturistit" në vitet e '80-ta.

uzina dhe kombinatet të mëdha. Të gjitha këto po i ngrehim me duart tona, me djersën tonë, me shpatullat tona. Por do të vijë edhe ajo kohë... Një ditë, në bisedë e sipër mes kolegëve të punës, Shasivari u tregonte shokëve se si e kishim kaluar në Shqipëri, një koleg serb i thotë Qalit "...pasi po iu pëlqen aq shumë Shqipëria, pse nuk po shkoni të jetoni atje?" E Qali, si gjithëherë që përgjigjen e kishte në majë të gjuhës, ia ktheu: "Po ne në Shqipëri jemi. A nuk po ndien erën e saj? Po ti nuk ke faj, se nuk i ke në rregull shqisat e të

nuhaturit". Kolegu serb u vërejt në fytyrë dhe nuk bëzajti më. Dhe kishte të drejtë Shasivari sepse atëherë minierës së qymyrit në Bellaqevc i thoshin herë "Shqipëri e vogël" e herë "miniera shqiptare". Pas disa kohe inspektori federativ i sigurimit, Lutfi Ajazi, shumë herë e thirri në biseda informative Shasivarin për vizitën në Shqipëri duke e këshilluar që të mos fliste shumë për atë ekskursion sepse e dëmtonte veten dhe rrethin. Rrallëherë fliste për torturat psikike që i kishte pasur nga inspektori për organizimin e

ekskursionit, për takimin me Sokrat Plakën dhe Ilia Robjën në Ambasadën e Shqipërisë dhe për pyetje dhe provokime të tjera. Ai prej natyre ka qenë veprues, por i heshtur.

Një nga shokët, në dalje të sallës së teatrit, pyeti me kureshtje se nga i ranë ndërmend këto fjali Meritës në këto momente? Po tradita në familje e bën veten, ia ktheu shoku tjetër. Ne e kemi dëgjuar disa herë se breza të tërë të makollëve e kanë ruajtur brezin kufitar që nga Çuka e Drazhnjës, Merdari, Përpellaci e deri te vija kufitare e Karadakut të Gjilanit, nga zaptuesit e egër bullgarë e serbë. Ne kemi dëgjuar se familja e makollëve i kanë dhënë bukë dhe i ka strehuar trimat Musli Dumoshin dhe Azem Bellaqevcin (Jashanicën) pas Luftës së Dytë Botërore. E dimë, gjithashtu, se djali i makollëve ia kalli datën Dushan Turuqicës në mes të ditës dhe prej atëherë krejt krahina e Llapit mori frymë lirisht. Kush iu gjet afër, në kohën më të vështirë, bacës tonë, Adem Demaçit, pos djali trim i makollëve, Shasivari? Nuk e tha kot pak më parë gjenerali i ushtrisë shqiptare, Kudusi Lame, se Shasivari nuk ndodhej rastësisht afër fuqisë kombëtare, Adem Demaçit. Patën shumë pika të përbashkëta baca Adem dhe Shasivari, por kryesoren e patën Nënë Shqipëri.

Pas luftës së UÇK-së Shasivari u angazhua me mish e me shpirt (si i thonë fjalës) për riaktivizimin e KEK-ut, me gjithë shokët që i kishte pranë. Në dy vjetët e para KEK-u u ringjall plotësisht. Pastaj u hetua një plogështi në entuziazëm të punës. Qali e hetoi që nuk ishte më koha e sakrificës së Shkurte Pal Vatës me shokë. Tani sakrificat ishte zëvendësuar me interesin vetjak. Pra, kishte vdekur ideja e heronjve të punës... Përkundrazi...! Ishin ngjallë orekse të tjera...! Me rëndësi është se Shasivar Makolli, përmes vajzës së tij, Meritës, ua la porosinë brezave që vijnë pas nesh, se era (aroma) e vetme që i rrit brezat tanë dhe i bënë të shëndetshëm, është aroma e Shqipërisë.

Prishtinë, 07.05.2019

## Përkujtohen dëshmorët e fshatit Staradran

**BURIM, 7 MAJ (ER)** - Në fshatin Staradran të Komunës së Burimit janë përkujtuar dëshmorët Demush Mavraj, Bekim Mavraj dhe Ibish Mavraj. Me këtë rast, në Shkollën Fillore "Ismajl Qemajli" është mbajtur një

mbledhje përkujtimore, pas-taj është bërë edhe zbulimi i pllakës përkujtimore i Shtabit Lokal në shtëpinë e dëshmorit Bekim Mavraj. I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës nga rad-

hët e AAK-së, Bekë Berisha. "Nëse kthehem 22 vjet më parë, këtu ishte një katrahurë dhe kishte dhjetëra e mijëra njerëz nga Mitrovica dhe vendet e tjera, të cilët banorët e fshatit Staradran i kanë ushqyer dhe mbrojtur. Po

ashtu, ka qenë vend i aktivitetit të UÇK-së. Kjo shtëpi ka qenë një ndër shtabet e UÇK-së. Ne duhet t'i përkujtojmë këta dëshmorë, sepse liria jonë nuk do të vinte pa ta", ka thënë deputeti Berisha.



## ShBA-ja uron Pendarovskin për fitoren në zgjedhje

SHKUP, 7 MAJ - Shtetet e Bashkuara e kanë uruar Stevo Pendarovskin për fitoren në zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut. "ShBA-ja është një partner i fuqishëm i Maqedonisë së Veriut dhe shpresojmë për bashkëpunim me Stevo Pendarovskin dhe me të gjitha partitë politike, në

rrugën e Maqedonisë së Veriut për t'u bërë anëtarja e 30-të e NATO-s dhe në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian", thuhet në deklaratën e Departamentit amerikan të Shtetit, të cilën e transmeton shërbimi maqedonas i Radios Evropa e Lirë. Rrethi i dytë i zgjedhjeve presi-

denciale në Maqedoninë e Veriut u mbajt të dielën. Pendarovski, kandidat i partive në pushtet, e fitoi kandidaten e opozitës, Gordana Siljanovska-Davkova, me një epërsi prej rreth 6% të votave. Atë e uruan për fitoren edhe zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s.



# Papa Françesku: Bashkëjetesa në Maqedoninë e Veriut, shembull në Evropë



të humbasësh dhe mund të njihet se përmes solidaritetit dhe ndarjes mund të gjendet dalja dhe rruga drejt çdo zhvillimi genësor", tha ai. "Shpresoj se ju do ta ruani këtë solidaritet që është i domosdoshëm në këtë moment kritik të paparashikueshëm në dobi të çdo veprë nga puna humanitare vullnetare", ka theksuar Papa Françesku.

Papa Françesku më pas është përkulur para përmendores së Shën Terezës të vendosur para shtëpisë përkujtimore të shenjtore Nënë Tereza ku është takuar me liderët e komuniteteve fetare në Maqedoninë e Veriut. Zyra e Shtypit të Selisë së Shenjtë në Vatikan ka bërë të ditur se Papa do të takohet edhe me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të trupit diplomatik, si dhe me udhëheqës fetarë e njerëz të varfër.

Vizita e Papës ka ngritur në këmbë thujse gjithë aparatit shtetëror në masa të jashtëzakonshme të sigurisë. Për mbarëvajtjen e vizitës janë angazhuar qindra forca policore e ushtarake si dhe njësitet speciale anti-terror.

Rrugët, nga ku kaloi Ati i Shenjtë u bllokuan për qarkullim që nga e hëna, ndërsa të gjithë banorët e zonës qendrore u udhëzuan që të mos dalin pa nevojë.

Gjatë qëndrimit në Shkup, Ati i shenjtë do të pranojë edhe një dhuratë të Kosova, shtatoren e Nënë Terezës, të punuar nga familja e Isë H. Buzukut nga Tygjevci i Kamenicës. Njoftimi është bërë nga ambasadori i Kosovës në Shkup, Gjergj Dedaj.

Gjatë vizitës së tij të parë në Shkup, Papa Françesku tha se përkatësitë e ndryshme fetare dhe etnike, në mes të maqedonasve, shqiptarëve, serbëve, kroatëve dhe të tjerëve, kanë krijuar një mozaik të bukur, "i cili do të zbkurohet edhe më tej nëse do të dini ta bartni këtë mozaik edhe te gjeneratat e reja"

SHKUP, 7 MAJ - Papa Françesku arriti të martën në Shkup të Maqedonisë së Veriut. Kjo është vizita e parë në këtë shtet e një drejtuesi të kishës katolike. Ai drejtoi një meshë në përkujtim të Nënë Terezës, humanistes së njohur botërore dhe fitueses së Çmimit Nobel, që ka lindur në Shkup.

Ati i shenjtë, gjatë qëndrimit

njëditor në Maqedoninë e Veriut, u takua me presidentin në largim, Gjorge Ivanov dhe kryeministrin Zoran Zaev, i cili vizitën e Papës në Shkup e ka vlerësuar historike dhe që mbart mesazhin e pajtimtimit dhe solidaritetit. "Jam shumë i gëzuar që jam në vendin e shenjtore Nënë Tereza dhe mund të bëj një lutje në Kishën ku ajo është pagëzuar,

në Kishën "Zemra e Shenjtë e Jezusit", ka theksuar kryetari i Kishës romake-katolike, Papa Françesku, gjatë qëndrimit në Shkup. "Për mua do të jetë nder i madh që për disa orë do të mund të lutem në Shtëpinë Përkujtimore dedikuar asaj, e cila është ndërtuar në vendin ku ishte para kësaj Katedralja katolike", tha Papa Françesku. "Duhet të jeni të lumtur që bëni pjesë si bashkëqytetarë të kësaj gruaje të madhe", ka theksuar Papa Françesku pas takimit që ka pasur me presidentin në largim, Gjorge Ivanov dhe kryeministrin Zoran Zaev, ka njoftuar rfe. Papa Françesku është ndalur në rëndësinë e karakterit shumetnik që ka Maqedonia e Veriut si shtet.

"Përkatësitë e ndryshme fetare dhe etnike, mes maqedonasve, shqiptarëve, serbëve, kroatëve dhe të tjerëve, kanë krijuar një mozaik të bukur, e i cili do të zbkurohet edhe më tej nëse do të dini që ta bartni këtë mozaik edhe te gjeneratat e reja", ka theksuar Papa Françesku. Në fokus të fjalës së tij për mediat, ka qenë dhe përballja e Maqedonisë së Veriut me krizën e migrantëve. "Solidariteti me kohë që u është ofruar atyre, që atëherë kishin më shumë nevojë për atë, sepse krahas shtëpisë, punës dhe atdheut që i kanë humbur, ata i kanë humbur edhe më të afërmit e tyre, ju bën të ndershëm dhe flet për shpirtin e këtij populli, e cila e di se si është

## Pompeo anulon vizitën në Gjermani, takon sërish Lavrov

UASHINGTON, 7 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, anuloi vizitën në Gjermani, vetëm disa orë përpara se të mbërrinte në Berlin, për shkak të, siç u tha, "çështjeve urgjente".

Zyrtarët rusë thanë, ndërkohë, se Pompeo pritet të takojë ministrin e Jashtëm rus, Sergei Lavrov, në qytetin Soçi të Rusisë, më 14 maj. "Për fat të keq, duhet t'i riplanifikojmë takimet në Berlin për shkak të çështjeve

urgjente", tha zëdhënësja e Departamentit amerikan të Shtetit, Morgan Ortagus.

Ajo shtoi se takimet e Mike Pompeo me kancelaren gjermane, Angela Merkel, dhe ministrin e Jashtëm gjerman, Heiko Maas, do të ricaktohen. "Sekretari pret të jetë në Berlin së shpejti", tha Ortagus.

Pompeo ndoqi një takim të Këshillit të Arktikut në Rovaniemi të Finlandës, ku, të hënën, takoi edhe ministrin rus, Lavrov.

Zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, konfirmoi të martën se Rusia po përgatitet për takimin Pompeo-Lavrov në Soçi, më 14 maj.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se nuk e përjashton mundësinë që presidenti rus, Vladimir Putin, i cili shpesh kalon kohë në Soçi, po ashtu, të takojë Pompeo. Pompeo tha më 6 maj se ka zhvilluar "bisedime të mira" me Lavrov për një "gamë të gjerë çështjesh".





# BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E jashtëzakonshme

## Ndërtohet skulptura më e madhe e shpendëve në botë

Me një gjatësi 60 metra dhe gjerësi 45 metra, kjo është skulptura më e madhe e shpendëve në botë. Skulptura gjigante e betonit në zemër të Kerala në Indi, e quajtur Jatayu Earth Center, mori gjashtë vjet kohë për t'u ndërtuar. Ideja për një skulpturë të tillë ka ardhur nga regjisori dhe skulp-



tori indian Rajiv Anchal, i cili gjithmonë ëndëronte ta sillte në jetë zogun mitik Jatayun.

FOTO E DITES



Nxënësit e një shkolle islame në Indonezi, pjesë e recitimit të Kur'anit gjatë ditës së parë të muajit të agjërimit të Ramazanit. /AP/

E rrallë

## Elefanti mbyt një ushtar britanik

Një ushtar britanik është mbytur nga një elefant në një park kafshësh të egra. Mathew Talbot vdiq në një operacion



kundër gjuetisë në Malavi. 23-vjeçari u shkel me këmbë nga elefanti gjatë një operacioni për ta ndaluar vrasjen e

paligjshme të kafshëve të egra. Kjo është vdekja e parë në operacionet ushtarake të këtij lloji.

## BARSOLETA E DITËS



Dy të dehur, pasi dalin nga restoranti, i afrohen një taksisti që ishte aty afër dhe e pyesin:  
- Sa kushton vajta deri në Krujë për tre persona?  
Taksisti, i habitur, i pyet:  
- Pse tre?! Ju qenkeni dy!  
Të dehurit e pyesin:  
- Po ti, nuk do të vish me ne?




## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

### "HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.  
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

### "THE KID WHO WOULD BE KING",

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

### "CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

### "U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award@-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Keni aftësinë të dëgjoni njëherë përpara se të gjykoni. Do të jetë mjaft e thjeshtë që më pas të arrini në përfundime rreth një projekti.</p>	 <p><b>DEMI</b> Do ta bëni të pamundurën për të qenë sa më praktik sot. Nuk keni mjaft kohë në dispozicion për një situatë të caktuar.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Çdo gjë është në harmoni të plotë sot dhe gjendja juaj shpirtërore do të përçojë këtë ndjenjë energjie pozitive që ju karakterizon.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Sot do të kaloni disa orë tensioni dhe nervozizmi në çift. Përpiquni t'i ulni tensionet sepse mund të përfundojë në një debat të nderur.</p>	 <p><b>LUANI</b> Jeni euforik dhe plot ide të reja sot që do t'i ndani me këdo takoni në ditën tuaj. Mbani sytë hapur te njohjet e reja sepse jeni duke takuar personin e zemrës.</p>	 <p><b>VIRGJËRSHA</b> Disa impenjime të mërzitshme të ditës sot nuk po ju pëlqejnë aspak. Do të nxirri një pretekst për t'u larguar nga një vend i caktuar.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Me pak intuitë do të merrni çdo impuls që ju vjen nga ambienti rreth jush për ta kthyer në një projekt mjaft fitimprurës.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Do të përfshiheni nga emocione shumë të forta që mund t'ju tërheqin në një drejtim të gabuar. Nuk do ta kuptoni këtë gjë në fillim.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot nuk mund të jeni diplomat në ato që thoni për shkak të acarimit që ju shkakton një person i caktuar. Nuk do të njihni limite etike.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Nuk keni pse fshiheni pas frikës suaj, por duhet t'i bëni ballë një situatë që e keni krijuar po ju. Kërkohet një zgjidhje sa më parë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot po shikoni me pozitivitet çdo gjë. Kjo sjellje do të tërheqë në orbitën tuaj njerëz interesantë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Doni të dëgjoni atë zërin e brendshëm që ju thotë t'i merrni parasysh pasionet dhe dëshirat tuaja. Por, disa sakrificë konstante, për hir të familjes, nuk ju lënë të qetë.</p>

## Selena Gomezi në krahët e një mashkulli misterioz

**S**elena Gomez pothuajse një vit ia kushtoi kohën tërësisht vetes.

Këngëtarja dhe aktorja e famshme pësoi një tronditje të thellë pas ndarjes nga Justin Bieber në vitin 2018, i cili u martua me modeluesen Hailey Baldwin. Dhe duket se tani Selena ka gjetur qetësinë në krahët e një mashkulli tjetër. Ajo u fotografua në krahët e një mashkulli misterioz në Disneyland në Anaheim të Kalifornisë. 26-vjeçarja shihet duke mbështetur kokën në shpatullat e tij.




## Jennifer Lopez edhe një herë merr krejt vëmendjen në Met Gala



**N**ë botën sportive Alex Rodriguez është një gigant i vërtetë, por në skemën e madhe të kulturës pop ai thjesht nuk mund të krahasohet me famën e të fejuarës, Jennifer Lopez.

Në fund të fundit, ajo është J. Lo. Është e vështirë të mundësh J. Lo në ndonjë gjë. Në paraqitjen e saj në tapetin e kuq, Jenniferi mori vëmendje për të tretën vjet rresht.



## Martohet Gina Rodriguez

**G**ina Rodriguez është martuar të shtunën me Joe LoCicero. Lajmi u konfirmua përmes "Instagram"-it, ku Gina ka postuar një video. "Faleminderit vjehrrës sime për martesën e ëndrrave të mia dhe fshatit që e ndihmoi atë", ka

shkruar ajo. Në video, Rodriguez shkëlqen në fustanin e saj të bardhë nga mëndafshi, ndërkaq bashkëshorti i saj me një kostum blu. Rodriguezi konfirmoi fejesën e saj me LoCicero në gusht, megjithëse u spekuloi se çifti u fejuan në korrik.

## Chris Brown fut në sherr Rihannën me të dashurin miliarder?



**R**ihanna merr miliona reagime nga postimet në "Instagram", por nuk i ka shpëtuar komenti i ish të dashurit Chris Brown. Pasi promovoi linjën e re të të brendshmeve, këngëtari ka shkruar: "Vazhdo të ecësh para mbretëreshë". Nuk mungoi edhe kërkesa e Chrisit që të dëgjojë sa më shpejt një këngë të re.

Burime për mediat e huaja konfirmojnë se Rihanna i ka lexuar komentet dhe ndihet shumë e emocionuar. Madje mendohet se asaj i janë kthyer në mendje disa çaste të bukura që ka kaluar me Chrisin dikur. Nuk dihet nëse këto lajme që qarkullojnë do të ndikojnë në lidhjen e saj me të dashurin miliarder, Hassan Jameel.



<b>EPOKA E RE</b>		<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	KËNGËTARJA NË FOTO	SECILA NGA PJESET QË FORMOJNË NJË TË TËRË	POLITIKANI ITALIAN KHANFRANKO	SEND QË PËRDORET PËR TË LUAJTUR (shq.)	"T" në mes të dy "E"	BASHKËT.	SOKOL BASHOTA	<b>EPOKA E RE</b>	TË FIKËT	ARMË GJAHU ME NJË TYTË DHE ME FISHEKË SI TË ÇIFTES	OLIVER NEUVILLE
		VEPRIM I VETVETISHËM DHE I MENJ-ËHERSHËM								PËREMËR VETOR FUTBOLLISTI .... BAJRAMI			
		KONGRESMEN I AMERIKAN ..... ENGEL						AKTORJA DHE MODELJA RODRIGUEZ SPORTIST QË MERRET ME NOT					
		ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ BOUDEWIJN							SHOK, JARAN LECCE				SHKRIMTARI KELMENDI
		EMËR MASHKULLI MYSLIMAN					REGJISORI I FAMSHËM ..... STONE RIFAT KUKAJ						
		RENIUM			TË BUKURIT (pashq.) ELEMENT KIMIK (TA)				RAMADAN AVDIU EMËR YNI MASHKULLI			ZANORE GOJËTAR	
		ROK BEND I YNI				DREJTIM QËLLIM I PARAMEND- UAR				LIGJ, KANUN (vjet.) NJË PLANET			
		SULM, MËSYMJE					KORNIZË TUNDEM, LËKUNDEM, SHKUNDEM ME FORCË				"RIZONI" FUTBOLLISTI YNË ZEJNULLAHU		
<b>EPOKA E RE</b>	FILM I REGJISORIT ISA QOSJA	I EMËROVA NË NJË DETYRË	THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.)	NEGRI, ZEZAK	KËSTI BANKAR	BINARËT E TRENIT ZANORE				DOLLAP I VOGËL PËR TË MBAJTUR ZOGJ			
		BIMË QË BËN KOKRRA TË VOGLA E QË HAHEN					TERMINATE STAY RESIDENT QË RUHET NGA DIKUSH; I .....			PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA DEM, KA			QË PËRSHKOHET NGA PATOSI
		RRETHI QË VIHET NË GISHT I STOLI ARI				BEKIMET				SHENJË NDALESE BESNIK (perkdh.)			
		KRYENGRITËS QË DILTE MALIT E LUFTONTE PËR LIRINË E ATDHEUT				"RULERA" ROLL BACK MALARIA		NËNNDARJE E NJË LIGJI GURRAT			NJËSI KOHE KËNGËTARJA E FAMSHME FRANKLIN		
		AKTORJA E SHQUAR THURMAN			REGJISORJA KALLABA VENDLINDJA E ODISEUT			AKTORI MORINA BANOR I NJË SHTETI AZIATIK					TOTENHAM 365 DITË
		GOJËDHËNA			PEMË E VENDEVE TË NGROHTA E QESHURA TALLËSE				KADRI ROSHI I KORR			PRODUKT I PULËS TËRËSI E ORENDIVE	
		INDIUM		REGJISORI AMERIKAN ... BURTON NJË PIJE ALKOOLIKE		NDËRRIMI I MALLIT (krah.) KALJARI				ALBANOLOGIA ... DURHAM LETRARI ... ASLLANI			
<b>EPOKA E RE</b>	VEZAK SHTET FEDERAL NË SHBA					LAJM HAP BRUMIN ME PETËS				SECILA NGA DY BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI BIMË QË PËRDORET SI USHQIM (sh.shq.)			
		JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHITJE TË DREJTËSISË				NOTË MUZIKORE FUQI, FORCË		BANOR I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN FIGURË SHAHU					BASHKËT. KRITERE
		RADIOLOK-ATORËT					PËRÇARJE BASHKËT.				OHAJO, PENSILVANIA TOKË E BUKËS (sh.shq.)		KONFERENCË ME KARAKTER NDËRKOMB-ËTAR
		ZANORE	KORÇA REPERI I FAMSHËM ..... DOGG (shqip.)		I ÇEL			KALI I SHALËS POETI VINCA		NËPËR ARA, ARAVE VAJ KUZHINË QË PRODHOHET NË SHQIPËRI			
		ZEN SUPPLIERS AUTOMOTIVE			BASHKË, ME (bised.) KËMBËZ SHKALLE, SHKALLARE		DILETANT ZET, RENIUM					RESHAT ARBANA AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE RICHARDS	
		OLIVIA NORMAN		POPULL QË KA BANUAR NË PELLGUN E EGJEUT (hist.) SELEN						LAKESË KAM DIJENI PËR DIÇKA			
		FEMRAT E PORSAMARTUARA				NUMËR THEMELOR TREVISO		BOTIMI EVERTON					
		OREKS					PËRHAPJE E VALËVE				AKTORI HOLLIVUDIAN ... DAMON (perkdh.)		



# Hitleri dhe “Volkswageni i tij brumbull”

Dy burra, një projekt i madh: Adolf Hitleri dhe Ferdinand Porsche janë krijuesit e veturës “brumbull” Volkswagen. Porsche është konstruktori gjenial, Hitleri ai që ndihmoi politikisht në lindje. “Këtu e gjetën njëri-tjetrin dy vetë që përshatashin me njëri-tjetrin”, konkludon historiani Wolfram Pyta, profesor i historisë së re në Universitetin e Shtutgartit. Së bashku me kolegët historianë Nils Havemann dhe Jutta Braun ai ka shkruar në librin “Porsche. Nga zyra e konstrukcionit në markë botërore” historinë e koncernit, të themeluar më 25 prill 1931 në Shtutgart. **Përmbledhtazi:** Pa mbështetjen e Hitlerit, Porsche nuk do ta kishte përfunduar dot projektin e Volkswagenit: “Hitleri kishte nevojë për një mendje krijuese, për të ndërtuar një automjet të vogël, të përshtatshëm për t’u prodhuar në seri”, thotë Pyta. “Kurse Porsche kishte nevojë për një porosidhënës politik, që t’i mundësonte të mos prodhonte nën presionin e kostos.”

## Motorizimi dhe mobilizimi

Që në ekspozitën e automjeteve në shkurt 1933, pra pak javë pasi e kishin emëruar kancelar të Rajhut, Hitleri pati shpallur “motorizimin e popullit”. Në verë 1934 “Shoqata e Rajhut e Industrisë Automobilistike Gjermane” e ngarkoi Porschen që të konceptonte një automjet “fuqi përmes gëzimit”, i quajtur me të njëjtin emër si organizata naziste e organizimit të kohës së lirë.

Në 29 dhjetor 1935, Hitleri, i cili vetë nuk kishte patentë shoferi, e mori personalisht në dorëzim një prototip të “Volkswagenit të tij”. Më shumë se dy vjet më vonë, në 26 maj 1938 u festua në prani të “Fyhrerit” vënia e gurit të themelit të fabrikës së Volkswagenit në Wolfsburg. Por automjeti i “fuqisë përmes gëzimit” fillimisht nuk i shërbeu motorizimit të popullit, por Vehrmahtit. Ai u përdor në front, si automjet terreni: xhip i vogël transporti mallrash dhe si automjet amfib.

Por askush nuk u çudit për këtë përdorim ushtarak. Sepse shndërrimi që përcaktuar që në krye. Në një ekspozitë të Porsche-s të vitit 1934 shkruhej se “një Volkswagen nuk duhet të jetë i përshtatshëm vetëm si automjet transporti, por edhe si automjet për furnizim dhe për synime të caktuara ushtarake”.

## Një Volkswagen francez?

Historia e suksesit e automjetit të vogël për popullin nisi vetëm pas luftës. Për ta hequr nga supet të kaluarën naziste, atij ia ndërruan emrin në “brumbull”. Që në dhjetor 1945 – një gjysmë viti pas fundit të luftës – nga fabrika doli brumbulli i parë. Dhjetë vjet më vonë Volkswageni festoi ekzemplarin e miliontë. Vetura me kurriz dhe me motor Boxer avancoi në simbol të mrekullisë ekonomike gjermane. I njohur me emrin “Beetle” ai pati në të gjithë botën shitje rekord. Gati 22 milionë brumbuj u prodhuan gjithsej dhe u shitën.

Të kaluarën e tij nacionalsocialiste brumbulli e la pas në periudhën e pasluftës. Pikërisht ministria franceze për prodhimin industrial, e drejtuar nga komunistët, vendosi në tetor 1945 kontakt me Porschen. “Që shkëputja nga nacionalsocializmi u bë me sukses, kjo nuk shihet askund më qartë se në përpjekjen e qeverisë franceze për ta fituar konstruktorin e Volkswagenit për shërbimet e veta”, thotë historiani Pyta.

## “Optimizëm pa kufi”

Konkurrenca franceze diti megjithatë si ta pengonte një “voiture populaire” gjermane. “U krijua një intrigë e konkurrentëve Renault dhe Peugeot”, deklaroi Pyta në bisedë me DW. “Porsche-n dhe kunatin e tij Anton Piëch e akuzuan se kishin marrë pjesë në krime lufte”.

Pas kësaj, papritur në dhjetor 1945 Porschen e arrestuan autoritetet ushtarake franceze, të cilat e mbajtën në arrest deri në gusht 1947. Por suksesin e përbotshëm të brumbullit kjo megjithatë nuk e pengoi.

Për historianin e njohur Pyeta, bashkëpunime si ai i Porsches dhe Hitlerit nuk janë kaq të jashtëzakonshme: aktorë të ashtuquajtur jo politikë shpesh impresionohen, kur sundimtarë autoritarë i tërheqin me projekte të mëdha magjepsëse: “Porsche nuk qe i vetmi që pa asnjë rezervë morale iu hodh në qafë pushtetarëve me një oportunitizëm pa kufi”, thotë Pyta.

“Persona përgjegjës për ekonominë, të cilëve u intereson vetëm sukcesi i sipërmarrjes së tyre ose zbatimi i projekteve ambicioze teknike, herë pas here nuk kanë rezerva që të lidhin pakte me pushtetmbajtësit.”



Ferdinand Porsche (majtas) i tregon Adolf Hitlerit një model të Volkswagenit



Hitleri sheh Brumbullin e parë të Volkswagenit, Porsche në këmbë (pa kapele)



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**  
TEL: 045 82 82 82

# Dautaj: Ferizaj mbijeton pa barazh

Qëndrim Dautaj për "Epokën e re" ka thënë se skuadra e Ferizajt do të mbijetojë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll pa pasur nevojë të luajë në ndeshjet e barazhit. "Na kanë mbetur të zhvillojmë edhe dy ndeshje si mysafirë dhe një si vendës ndaj Gjilanit, por shanset janë të mëdha që Ferizaj të mbetet në Superligë pas pasur nevojë të luajmë në barazh", ka thënë Dautaj

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 MAJ - Katër fitore në katër ndeshjet e fundit kanë bërë që skuadra e Ferizajt të largohet nga zona e barazhit. Futbollisti Qëndrim Dautaj është shprehur i lumtur për formën e skuadrës së tij, kurse për mbetjen e Ferizajt në IPKO Superligë ka thënë se nuk ka nevojë të luajë në barazh. "Kemi marrë tri pikë shumë të rëndësishme ndaj Lirisë dhe kemi vazhduar serinë e fitoreve në Superligë. Normalisht se kjo fitore na jep motiv shtesë që edhe në tri ndeshjet e ardhshme t'i kërkojmë pikët që na largojnë përfundimisht nga zona e barazhit. Na kanë mbetur të zhvillojmë edhe dy ndeshje si mysafirë dhe një si vendës ndaj Gjilanit, por shanset janë të mëdha që Ferizaj të mbetet në Superligë, pa pasur nevojë të luajmë në barazh", ka thënë Dautaj për "Epokën e re".

Të premtën skuadra e drejtuar nga Bylbyl Sokoli është mysafire e skuadrës së Trepçës '89. Dautaj ka konfirmuar se rezultati pozitiv është synimi i skuadrës së tij për këtë ndeshje. "Ndeshje e vështirë na pret ndaj Trepçës '89 për faktin se të dyja skuadrat nuk janë rehat në tabelën e klasifikimit, por ne jemi të vendosur dhe do të angazhohemi që të marrim një rezultat pozitiv", ka shtuar ai. Më 8 prill Ferizaj e pësoi humbjen e fundit nga Prishtina, kurse në ndeshjen tjetër e mposhti Feronikelin, pastaj Flamurtarin, Ballkanin dhe, në fund, Lirinë. Dautaj ka vlerësuar se në formën e mirë të skuadrës kanë ndikuar përgatitjet dyjavore në Shqipëri, por edhe fitorja ndaj "Niklit" në Drenas. "Në katër ndeshjet e fundit ka ardhur në pyetje përgatitja fizike ku, pas



pushimit prej 14 ditësh, ishim në Shqipëri dhe kjo po shihet që ka qenë mjaft e dobishme, por pa e mohuar edhe faktin se fitorja ndaj Feronikelit na ka dhënë një motiv shtesë që ndeshjet e ardhshme t'i luajmë sa më mirë dhe mendoj se kemi bërë diçka që pakkush e ka besuar. Megjithatë, ende nuk ka përfunduar asgjë dhe nëse mbesim jashtë zonës së barazhit do të ishim të lumtur të gjithë lojtarët, trajnerët dhe tifozët "Ujqit", ka përfunduar Dautaj.

Skuadra e Ferizajt aktualisht zë vendin e tetë në Superligë me 37 pikë

të grumbulluara, dy më shumë se Ballkani dhe tri më shumë se Gjilani që janë në zonën e barazhit.

## IPKO SUPERLIGA - JAVA E 31-TË

**Të premtën takohen:**  
Ballkani - Gjilani  
Trepça '89 - Ferizaj  
Flamurtari - Drenica

**Të shtunën takohen:**  
Prishtina - Llapi  
Feronikeli - Drita  
Liria - KEK-u

## SHKURT

### Më 24 maj zhvillohet finalja e Kupës

Ndeshja finale e Digitalb Kupës së Kosovës ndërmjet Feronikelit dhe Trepçës '89 do të zhvillohet më 24 maj në orën 20:45 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Këto dy skuadra u kualifikuan në finale, pasi i kaluan me sukses dy sfidat gjysmëfinale kundër Ballkanit, përkatësisht Vëllaznimit. Feronikeli synon trofeun e tretë të kësaj gare, pasi e ka fituar atë dy herë radhazi në vitet 2014 e 2015, derisa Trepça '89 synon ta fitojë këtë trofe për herë të dytë, pasi për herë të parë iu kishte gëzuar kupën në vitin 2012.

### Zeneli, lojtari i muajit te Reimsi

Arbër Zeneli është shpallur lojtari më i mirë i muajit mars te skuadra e Reimsit. Ylli shqiptar po shkëlqen te skuadra franceze, duke fituar tashmë një çmim tek ekipi i Ligës 1. Golashënuesi më i mirë i Përfaqësueses së Kosovës në muajin mars kishte arritur të shënonte dy gola dhe ka bërë katër asistime. Ky ishte çmimi i parë për 24-vjeçarin pasi e kompletoi transferimin në afatin kalimtar dimëror te Reimsi.

### Pranvera Ferataj: Tani synojmë edhe titullin

Pranvera Ferataj ishte e pandalshme të dielën në finale të Kupës së Republikës së Kosovës në hendboll. Ajo udhëhoqi Istogun drejt fitores ndaj Vushtrrisë duke shënuar plot 11 gola, 9 prej tyre në pjesën e parë. Ferataj ka shkëlqyer përmes kundërsulmeve që i ka finalizuar me gola të bukur. "I kemi njohur ekipet kundërshtarë e, po ashtu, kapacitetin e ekipit tonë. Qëllimi ynë ka qenë vetëm fitorja dhe ia arritëm. Pasi e kemi fituar kupën, me plot meritë tani i kthehemi punës për përgatitje sa më të mirë për 'play-off'. Shpresojmë që kupës t'ia bashkojmë edhe trofeun e kampionit", ka thënë Ferataj.

### Fiorentina interesohet për Gjimshitin

Fiorentina është duke u interesuar për mbrojtësin e Kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti. "Tuttomercatoweb" raporton se skuadra e Fiorentinës në javët e fundit ka treguar interesim për mbrojtësin shqiptar, i cili është pjesë e rëndësishme e skuadrës së Atalantës. Ofertat për 26-vjeçarin nuk kanë munguar edhe në afatin kalimtar, kurse në të kaluarën ky futbollist ka luajtur edhe për Zurichin, Avellinon dhe Beneventon.

## Java e fundit vendos për vendin e katërt për 'play-off'

Prishtinë, 7 maj - Sot (e mërkurë) dhe nesër (e enjte) luhen ndeshjet e xhiros së fundit (28) të stinorit të rregullt në Superligën A të Kosovës në hendboll (meshkuj). Tashmë dihet që në "play-off" kampionia aktuale, Besa Famgas, do të fillojë nga pozita e parë. Skuadra pejane udhëheq në tabelë me 50 pikë. 47 pikë në vend të dytë i ka Kastrioti i

Ferizajt, që të dielën e fitoi Kupën e Kosovës. Edhe vendi i tretë është caktuar. Prishtina do ta nisë "play-off"-in e treta, ndërsa një xhiro para fundit i ka 39 pikë. E hapur ka mbetur vetëm gara për vendin e katërt, në të cilin aktualisht është Vëllaznimi me 22 pikë. Vushtrria është e pesta me 21 pikë, ndërsa Drita e gjashta me 20 pikë. Të mërkurën janë ndesh-

jet Besa Famgas - Drita (18:00) dhe Kastrioti - Vëllaznimi (19:00). Ndeshja e fundit, që mund të jetë edhe vendimtare, në mes të Vushtrrisë e Prishtinës, luhet të enjten nga ora 20:30. Në "play-off", në gjysmëfinale, do të luajë Besa Famgas me skuadrën e vendit të katërt dhe Kastrioti i vendit të dytë me Prishtinën e vendit të tretë.



## Duro: Gabova që shkova te Drita

TIRANË, 7 MAJ - Trajneri Shpëtim Duro në emisionin "Kampionët" në "Vizion Plus" ka thënë se ka gabuar që mori drejtimin e skuadrës së Dritës nga Gjilani. "Te Drita kisha objektiv Kupën dhe, pas elim-

inimit, duhej të largohesha. Ishte një gabim që shkova te Drita pasi skuadra, nga kampione, kishte përfunduar në vend të fundit dhe çfarë mund të bënte një trajneri në atë lloj situatë, por ndonjëherë detyro-

hesh të marrësh disa vendime edhe për shkak të situatës ekonomike. Dua që në skuadrën e radhës të kem një projekt serioz, ku mund të punoj qetë. Ka disa trajnerë në Shqipëri që ndërrojnë 3-4

skuadra në vit. Unë nuk e kuptoj këtë", ka thënë Duro. Aktualisht në futbollin e Kosovës janë duke punuar vetëm dy trajnerë: Mirel Josa (Prishtina) dhe Gentian Mezani (Gjilani).



## Tottenhami në Holandë për ta përmbysur Ajaxin

AMSTERDAM, 7 MAJ - Tottenham Hotspur pësoi humbje në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve si vendësja e kaluar nga Ajaxi (0-1), kurse më pas humbi edhe ndeshjen e fundjavës në Premierë Ligë nga Bournemouthi (1-0). Tash skuadra e drejtuar nga Mauricio Pochettino kërkon rikthimin e fuqishëm në ndeshjen kthyesë ndaj holandezëve të Ajaxit në ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Johan Cruyff Arena", por rikthimi nuk do të jetë aspak i lehtë për "Spursin" për faktin se Ajaxi ka qenë fantastik në këtë edicion duke eliminuar skuadra si Real Madrid dhe Juventusin.

Tottenhami me shumë fat e eliminoi në çerekfinale skuadrën e Manchester Cityt, por ndaj Ajaxit i duhet shumë punë për ta arritur finalen e madhe. "Finalja kundër Barcelonës do të ishte krejtësisht e veçantë. Sidoqoftë, unë nuk dua të flas ende për këtë, sepse nuk do ta respektoja Tottenhamin. Kemi ende për të bërë. Do të luhet edhe gjysmëfinalja e kthimit. Ne do të duhet të luajmë më mirë se javën e



### FORMACIONET E MUNDSHME

Ajax: Onana, Mazraoui, De Ligt, Blind, Tagliafico, Schone, De Jong, Ziyech, Van de Beek, Neres, Tadiq.  
Tottenham: Lloris, Trippier, Vertonghen, Alderweireld, Rose, Wanyama, Sissoko, Alli, Eriksen, Son, Lucas.

kaluar në Londër. Pjesa e parë e jona ishte shumë e mirë. Në pjesën e dytë, Tottenham ishte më shumë i pranishëm në fushën tonë dhe na vuri në vështirësi. Tani duam më shumë. Nuk jemi të kënaqur vetëm me këtë titull, Kupën e Holandës". Trajneri Pochettino shpreson se në këtë ndeshje ta ketë të gatshëm mbrojtësin veteran Jan Vertonghen,

i cili u lëndua pas një përplasje javën e kaluar me shokun e skuadrës, Toby Alderweireld. Lajm i mirë për skuadrën angleze është rikthimi nga suspendimi i Heung-min Son dhe Juan Foyth, por Harry Kane mungon sikurse edhe Harry Winks, Serge Aurier dhe Erik Lamela. Mungesa te vendësit janë Hassane Bande dhe Carel Eiting.

## Hardeni thyen kampionët në fuqi

HOUSTON, 7 MAJ - Milwaukee Bucks është në rrugë të mbarë dhe është një fitore larg finales së Konferencës së Lindjes, pasi ka mundur në ndeshjen e katërt me rezultatin 101-113 Boston Celticsin. Ndërkohë Houston Rocketsi vijon të rezistojë, pasi mposhti me sukses kampionët në fuqi. Golden State Warriors nuk rezistoi dot dhe ndeshja u mbyll 112-108. James Hardeni ka bërë një superndeshje, teksa ka shënuar 38 pikë si dhe ka regjistruar 5 asistime dhe 10 topa të rikuperuar në tabelë. Eric Gordon me 20 pikët e realizuara, si dhe P.J. Tucker (17 pikë, 3 asistime, 10 rebound) dhanë një ndihmë të madhe që



### GJYSMËFINALET E KONFERENCËVE

Boston Celtics-Milwaukee Bucks	101-113	(1-3)
Houston Rockets-Golden State Warriors	112-108	(2-2)

Rocketsi ta arrinte triumfin. Nga ana tjetër, te Warriorsi spikatën Kevin Duranti (34 pikë) dhe Stephen Curry (30 pikë), por edhe Draymond Green (15 pikë, 5 asistime, 10 rebounde) u

paraqit mirë. Për t'u rikthyer te fitorja e Milwaukee Bucks. Giannis Antetokounmpo ishte ylli i mbrëmjes në fitoren ndaj Celticsit. Plot 39 pikë të shënuara nga greko-nigeriani. Ai regjistroi edhe 5 asistime, ndërkohë që ishte "mbret" në tabelë, duke rikuperuar 16 topa. Kyrie Irving (23 pikë), Al Horford (20 pikë), Marcus Morris Sr. (18 pikë, 2 asistime, 14 rebounde) dhe Jayson Tatum (17 pikë, 4 asistime, 10 rebounde) nuk ia dolën dot ta ndalnin hovin e Bucksit që pas periodës së parë ishte më lart se Celticsi.

## Guardiola: Ne jemi të parët, goli ishte i jashtëzakonshëm

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, është shumë i lumtur se skuadra e tij arriti fitore ndaj Leicester Cityt (1-0). Cityt i ka mbetur vetëm edhe një ndeshje që të shpallet kampion në Premierë Ligë. "Një gol i jashtëzakonshëm, pa asnjë diskutim. Luajtëm në mënyrë të pabesueshme. Prisja që Leicesteri

të ishte më ofensiv, por u mbrojt. Pjesë e parë ishte e mirë, e dyta e shkëlqyer. E dinim për çfarë luanim. Më vjen keq për shumë njerëz dhe mediet që shpresonin që Liverpooli të ishte i pari, por ne jemi ende atje", ka thënë Guardiola. "Kompany ka këtu më shumë se 10 vjet dhe ka ndihmuar këtë brez të pabesueshëm

lojtarësh së bashku me Hartin dhe Zabaletan për ta krijuar këtë klub. Kur Kompany shtyn përpara në çaste të rëndësishme dhe është mirë fizikisht, është një lojtar i pabesueshëm. Tani e kemi në dorë. Edhe një ndeshje, e të mendosh se kemi qenë 7 pikë pas Liverpoolit", ka deklaruar Guardiola.

### SHKURT

#### Azmaiparashvili vizitoi KOK-un

Presidenti i Unionit Evropian të Shahut, Zurab Azmaiparashvili, ka vizituar të martën Komitetin Olimpik të Kosovës, ku është pritur nga nënpresidenti i KOK-ut, Gazmend Maxhuni. Azmaiparashvili shoqërohej nga kryetari i Federatës së Shahut të Kosovës, Nysret Avdiu, si dhe mjeshtëri i shahut nga Shqipëria, Erald Dervishi. Maxhuni e njoftoi presidentin Azmaiparashvili me përkrahjen e vazhdueshme që komuniteti i shahut ka nga KOK-u përmes organizimit të kurseve për administratorë si dhe formave të tjera. Presidenti Azmaiparashvili, që vjen nga Gjeorgjia, u shpreh falënderues për pritjen, derisa kërkoi që KOK-u ta vazhdojë mbështetjen për Federatën e Shahut të Kosovës. Të dyja palët biseduan edhe për çështje të tjera në interes të komunitetit të shahut në Kosovë.

#### Përfundon sezoni për Paquetan

Lucas Paqueta e teproi me preken e gjyqtarit dhe e ka pësuar keq. Brazili i Milanit u ndëshkua me të kuq në ndeshjen e mbrëmjes së kaluar kundër Bolognas. Tensioni i madh dhe ndërhyrjet e ashpra e acaruan lojtarin ofensiv, i cili nuk u përmbajt as kundër gjyqtarit. Sot ka dalë edhe vendimi për të. Tri javë pezullim është dënues 21-vjeçari, që përthehet ndryshe fund i parakohshëm i sezonit. Kjo do të jetë një mungesë e madhe për trajnerin Gattuso. Kuqezinjtë kanë nevojë për fitore në tri ndeshjet e mbetura dhe gjërat do të vështirësohen edhe më shumë pa fantazinë dhe talentin e brazilianit në fushë.

#### Godini me lot largohet nga Atletico

Diego Godin do të largohet nga Atletico e Madridit në fund të sezonit për t'u bashkuar Interit. Mbrojtësi uruguaijan mbajti veshur fanellën e klubit nga kryeqyteti i Spanjës plot 9 vjet, teksa fitoi 8 trofe të rëndësishëm, duke u shndërruar në një legjendë. Në konferencën për shtyp uruguaijan nuk i kurseu as lotët teksa u shpreh: "Dua t'ju njoftoj se këto janë ditët e fundit këtu dhe ndeshjet e fundit me fanellën bardhëkuqe. Faleminderit të gjithëve! Ky nuk është një klub. Është një familje. Do të mbetem përgjithmonë një tifoz", ka thënë Godin. Vitin e kaluar Godini ishte shumë afër transferimit në Manchester United. "Unë zgjedha të qëndroj në atë moment. Ishte vendimi im dhe sot nuk më vjen keq. U përpoqa të qëndroja në këtë klub, u takuam kaq shumë herë në këta muaj, por në mënyrë të qartë nuk kemi gjetur një marrëveshje për të vazhduar së bashku. Ndryshimet të bëjnë të përmirësohesh dhe të rritesh. Nuk pendohej për asgjë. Unë do ta mbështes Atletico kudo që të shkoj", ka shtuar 33-vjeçari.

#### Joshua 'kërcënon' Wilderin dhe Furyn

Boksieri britanik Anthony Joshua ka dhënë një mesazh të rëndësishëm për dy kundërshtarët kryesorë Deontay Wilder dhe Tyson Fury. Dyshja e lartpërmendur u ndeshën mes vete në dhjetor dhe fituesi i atij meçi paramendohej të takohet me Joshuan, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Të dy e refuzuan kategorikisht meçin me të, por 29-vjeçari ka thënë se do të jetë e vështirë për ta sado që do ta zgjasin ditën e përballjes me të. "Sa më shumë të zgjasin meçin Wilder dhe Fury, aq më e vështirë do të jetë", ka thënë Joshua, i cili do të përballlet më 1 qershor me Andy Ruiz Jr në Nju Jork, pasi kundërshtari paraprak doli pozitiv në testet doping.

#### Conte nuk e merr drejtimin e Romës

Ish-trajneri i Përfaqësueses së Italisë, Antonio Conte, ka përjashtuar mundësinë për ta drejtuar skuadrën e Romës gjatë edicionit 2019/20, njoftojnë mediet italiane të martën. "Për momentin te Roma nuk janë kushtet për të punuar. Por, mendoj se në një të ardhme do ta drejtoj Romën", është shprehur Conte, i cili ka punuar te Chelsea e Juventusin, ekipe më të cilat ka fituar tituj kampioni. Pas distancimit nga Roma, për Conten në garë mbeten Interi dhe Milani.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister  
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenin 6 pika 5 dhe nenin 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:

**Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Anketues për Anketën Testuese të Pemëtarisë 2019
Numri i referencës:	ASK-DSBM-001
Tarifa e shërbimit:	I negociuar
Raporton te:	Njësia e Statistikave të Bujqësisë në ASK
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta-(MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Dhjetë (10) ditë
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK- 5 anketues

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative (Të dhënat e anketës, dhe të jenë të përgatitur për realizimin e Anketës Testuese të Pemëtarisë (Anketimin e FB-ve) në terren bazuar në udhëzimet për këtë Anketë.
- Të bëjnë grumbullimin e të dhënave për anketën testuese të pemëtarisë me metodologjinë CAPI (Tabletë).
- Të respektojnë udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që janë në pyetësor dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Para largimit nga ekonomia bujqësore të bënë kontrollimin e pyetësorit të plotësuar në tabletë për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Përdorimi i adresave dhe hartave (hartat vetëm në rastet problematike përdoren) për qarqet regjistruese dhe ekonomitë bujqësore të caktuara;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejt bënë kontrollimin dhe përmirësimin e të dhënave në Tabletë përmes sistemit para dhe pas sinkronizimit të anketës Tablete-Server dhe anasjelltas.
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën të cilën e flet ai komunitet.
- Të bëjnë raportimin ditor të mbikëqyrësi (ASK);
- Të përfundojnë Anketën Testuese të Pemëtarisë brenda afatit.
- Të mbajnë të gjitha informatat e pranuar në Ekonomitë Bujqësore të anketuara si sekret zyrtar.
- Të kthejnë pajisjet e pranuar nga ASK (Tablet), pas përfundimit të punës në terren.

**Përgatitja shkollore për anketues/përvoja:**

- Të jenë student (studentët e fakultetit të bujqësisë) kanë përparësi;
- Të kenë përvojë në anketat e mëparshme në bujqësi dhe në anketat tjera, e preferuar përvoja në anketat e zhvilluara me metodën CAPI (tabletë);
- Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit;

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë përfshi vikendet.
- Të jetë nga komuna ku kërkohet të zhvillohet Anketa Testuese e Pemëtarisë

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.**

Numri i anketuesve sipas komunave

Komuna	Numri i anketuesve
Istog	1
Rahovec	1
Suharekë	1
Gjilan	1
Podujevë	1
Gjithsej	5

**Paraqitja e kërkesave:** Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/> Aplikacionet dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr."Zene Salihu" nr.4 Prishtinë.

**Aplikacioni duhet t'i bashkëngjiten:** CV<sup>1</sup>, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, vërtetimi nga fakulteti që është student, diploma (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje), si dhe një dëshmi nga përvoja e punës sipas përshkrimit të detyrave të punës (Anketa e bujqësisë ,RB-2014 apo anketat tjera në veçanti ato të kryera me tabletë).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 prej orës 08:00 – 16: 00.

<sup>1</sup> Përfshi: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister  
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistiki Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

**Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge**

Naziv institucije:	Agencija za Statistiku Kosova
Naziv radnog mesta:	Anketar za Probnu Anketu Voćarstva 2019
Referentni broj:	ASK-OSPŽS-001
Tarifa usluga:	Po dogovoru
Izveštava:	Jedinica Statistika Poljoprivrede u ASK
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge-(SPU)
Trajanje ugovora:	Deset (10) dana
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK- 5 anketara

**Zadaci i odgovornosti:**

- Učestvuje u obukama i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima (podacima ankete i budu spremni za sprovođenje Probne Ankete Voćarstva (Anketiranje PG-a) na terenu na osnovu uputstva za ovu Anketu;
- Prikupiti podatke za probnu anketu voćarstva sa CAPI metodologijom (Tablet računom).
- Poštuje uputstva upitnika za pitanja koja su u upitniku i prati sve procedure i objašnjenja navedena u instrukcijama;
- Pre napuštanja poljoprivrednog gazdinstva kontroliše popunjeni upitnik da se osigura da su popunjeni odgovori na sva pitanja i sva uputstva praćena.
- Koristi adrese i mape (mape se koriste samo u problematičnim slučajevima) za određene popisne krugove i poljoprivredna gazdinstva;
- U saradnji sa direktnim supervizorom, kontroliše i ispravljanje podataka u Tablet računaru preko sistema pre i posle sinhronizacije ankete Tablet računaru-Server i obrnuto.
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na jeziku zajednice kojoj pripada ispitanik
- Dnevno izveštava svom supervizoru (ASK);
- Završi Probnu Anketu Voćarstva u propisanom roku
- Sve dobijene podatke u anketiranim poljoprivrednim gazdinstvima treba da čuva kao poverljive podatke.
- Vrati opremu (Tablet računare) primljenu od ASK nakon završetka rada na terenu.

**Školska sprema za anketara/iskustvo:**

- Da bude student (studenti Poljoprivrednog fakulteta) imaju prednost;
- Ima iskustvo u prethodnim anketama u poljoprivredi i drugim anketama, poželjno iskustvo u anketama u kojima je korišćena CAPI metoda prikupljanja podataka (pomoću tablet računara);
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja.

**Kompetencije i veštine:**

Veštine i veoma dobru saradnju za komuniciranje;

- Spremni za timski rad;
- Sposobnost prostorne orijentacije (korišćenje mapa za prostornu identifikaciju stambenih objekata);
- Ima dobre organizacione veštine i bude spreman/na da ponekad radi sa dužim radnim vremenom, uključujući i vikendom.
- Da bude iz opštine u kojoj će biti sprovedena Probna Anketa Voćarstva.

**Uslovi učešća na konkursu:**

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni (stariji od 18.godina) Gradani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

**Konkurs je otvoren 5 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb-stranici ASK-a.**

Broj anketara prema opštinama

Opština	Broj anketara
Istok	1
Orahovac	1
Suva Reka	1
Gnjilane	1
Podujevo	1
Ukupno	5

**Podnošenje prijave:**

Obrasci za prijavu mogu se dobiti U Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zene Salihu" br.4, Priština.

**Uz aplikaciju potrebno je priložiti:** CV<sup>1</sup>, Kopiju lične karte, dokumenat o prebivalištu, potvrda sa fakulteta koja dokazuje da je kandidat student, diplomu (svi dokumenti treba da budu kopije), kao i dokaz o radnom iskustvu prema opisu radnih zadataka (Anketa poljoprivrede, PP 2014 ili druge ankete, posebno one u kojima podaci su prikupljeni tablet računom).

Prijave poslate nakon poslednjeg datuma neće biti prihvaćene.

Nepotpune prijave biće odbijene.

Zbog velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće usmeno intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: 038- 200 31 149 od 08:00 – 16: 00 časova.

<sup>1</sup> Uključujući: Broj telefona i elektronsku adresu



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



### NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Në bazë të nenit 66 dhe 67 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullores nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rregullores nr. 03/2017 për procedurat e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese neni 15, paragrafi 3, në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përkatësisht për arsye të mos arritjes së balancuar të kandidatëve në aspektin etnik, njoftohen të gjithë aplikantët, për zgjatjen e afatit të konkursit të datës 20.04.2019 edhe për shtatë (7) ditë të tjera, i cili është publikuar në gazetën ditore "Bota Sol" dhe "Epoka e Re", dhe emituar në Radio K, për pozitën:

1. **KOZ-08/2019 Zëvendës Kryeshf Ekzekutiv në SKOZ**
2. **KOZ-09/2019 Drejtor Ekzekutiv në ZRPPC**

Përmbajtja e konkursit mbetet e njëjtë me konkursin e shpallur në datën e lartëshënuar. Konkursi mbetet i hapur shtatë (7) ditë kalendrike nga dita e publikimit, përkatësisht deri me datën 14.05.2019.

Kërkesat e dërguara pas kalimit të afatit për aplikim dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në numrin e telefonit 038 200 23 557.

### OBAVEŠTENJE O PRODUŽENJU ROKA KONKURSA

Na osnovu člana 66. i 67. Zakona br. 03/L-073, o Opštim izborima u Republici Kosovo, Uredbe br. 01/2017 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u Sekretarijatu Centralne Izborne Komisije, Uredbe br. 03/2017 o procedurama regrutovanja, imenovanja i probnom radu, členu 15, stav 3, u Sekretarijatu Centralne Izborne Komisije, usled nepostizanja uravnoteženog broja prijavljenih kandidata u etničkom aspektu, obaveštavaju se svi prijavljeni o produženju roka konkursa od datuma 20.04.2019 godine, za još sedam (7) dana, koji je objavljen u dnevnim novinama "Bota Sol" i "Epoka e Re" i emitovan na Radio K, za poziciju:

1. **CIK-08/2019 Zamenik Glavnog Izvršnog Službenika SCIK-a**
2. **CIK-09/2019 Izvršni Direktor u KRPPP**

Sadržaj konkursa ostaje isti kao u konkursu objavljenom na gore navedeni datum. Konkurs će biti otvoren sedam (7) kalendarskih dana od dana objavljivanja, odnosno do **14.05.2019**.

Zahtevi podneti nakon isteka roka za prijavu, i nepotpuni zahtevi neće biti razmotreni.

Za dodatne informacije, molimo vas pozovite broj telefona: 038 200 23 557.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agjencia za Statistiku Kosova - Kosovo  
Agency of Statistics

Agjencia e Statistikave të Kosovës lidhur me Konkursin me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSIV), të publikuar në gazetën "Epoka e Re" më datën 17.04.2019, bënë këtë:

### NJOFTIM

Mbi anulimin e konkursit për pozitën:

- **Intervistues dhe mbikëqyrës për të realizuar intervistat për Anketën EU-SILC 2019**
- **Numri i Referencës: ASK-DSS-001**

Anulimi i këtij konkursi bëhet duke u bazuar në Raportin njoftues nga Komisioni Përzgjedhës i Rekrutimit në ASK-se, i cili komision ka konstatuar se shumica e kandidatëve të cilët kanë aplikuar për këtë pozitë nuk e kanë plotësuar kriterin e përvojës së punës sipas konkursit të publikuar, prandaj konform dispozitave ligjore ASK-së fillon me një shpallje të re të rekrutimit për pozitën e njëjtë me një procedurë të thjeshtësuar sipas Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e cila publikohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Ju falënderojmë për mirëkuptim.

Agjencia za Statistiku Kosova u vezi sa Javnim Konkursom o Sporazumu za Posebne Usluge (SPU), koji je objavljen u dnevnom listu "Epoka e Re", dana 17.04.2019, objavljuje.

### OBAVEŠTENJE

O poništenju konkursa za poziciju:

- **Anketar/ispitivač i supervizor za sprovođenje Ankete EU-SILC 2019**
- **Referentni broj: ASK-OSS-001**

Poništenje ovog konkursa vrši se na osnovu obaveštajnog Izveštaja Komisije za odabir kadrova ASK-a, koja je utvrdila da većina kandidata koji su se prijavili za ovu poziciju nisu ispunili kriterijum radnog iskustva prema objavljenom konkursu. Stoga u skladu sa zakonskim odredbama, ASK će ponovo raspisati konkurs regrutovanja za istu poziciju, sa pojednostavljenom postupku u skladu sa Zakonom br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, koji će biti objavljen u skladu sa utvrđenim uslovima i procedurama u Uredbi 02/2010 o Procedurama Regrutovanja u Civilnoj Službi.

Hvala vam na razumevanju!

Strana 1 od 1

Adresa: UL "Zemal Sahbu" br. 4 10.000 Priština - Kosovo  
Telefon: 038 235 111 xxx / Faks: 038 235 033 / +377 (0)44 xxx xxx  
<http://www.ks.gov.net/esk>, e-mail: [esk@ks.gov.net](mailto:esk@ks.gov.net), e-mail: privat



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme / Departmanet za Financije i Opste Sluzbe /  
Department for Finance and General Services  
Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija Ljudskih Resursa / Human Resources Division

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kreu III, neni 11, dhe neni 22, paragrafi 3 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Drejtësisë shpall këtë:

### NJOFTIM

Njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar se konkursi i shpallur më datën 23.04.2019 për pozitën: Zyrtar Ligjor - 1 (një vend pune) me numër të referencës MD/ DL/23-04-01-2019 në Gazetën ditore „Epoka e re“ dhe në web - faqen e Ministrisë së Drejtësisë, vazhdohet edhe për shtatë (7) ditë kalendrike, nga data: 08.05.2019 deri më datën 14.05.2019.

Të gjithë Kandidatët të cilët kanë aplikuar në afat dhe procedure të rregullt për këtë Pozitë, nuk kanë nevojë për ri-aplikim.

### MINISTARSTVO PRAVDE

U skladu sa Zakonom Br. 03/L-149 za Civilnu Službu, Republike Kosova, Poglavlje III, člana 11 ovog Zakona, i člana 22, tačka 3, Uredbu Br. 02/2010 o Proceduri Regrutiranja u Civilnoj Službi, Ministarstvo Pravde objavljuje sledeće:

### OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi zainteresovani kandidati da Konkurs objavljen dana 23.04.2019 za pozicija: Pravni Službenik -1 (jedno radno mesto) sa broj referencije MP/PD/23-04-01-2019 na dnevnu novinu "Epoka e re" i u web-stranu Ministarstva Pravde, produžen je za sedam (7) kalendarskih dana, od 08.05.2019 do 14.05.2019.

Svi Kandidati koji su u regularnom roku i postupku aplicirali za ovu poziciju, nemaju potrebu za ponovno apliciranje.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Xhafa" Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810083254 me pronar Izote Xhafa, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVEŠTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa "Xhafa" D.O.O. Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810083254 sa vlasnikom Izote Xhafa, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Xhafa" L.L.C in Mitrovica, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810083254, Izote Xhafa the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA  
 MINISTRIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT  
 MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA  
 MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS  
 AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS  
 DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA  
 THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

**Datë 07.05.2019**  
**Prishtinë**

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës bënë këtë**

### Njoftim

#### MBI ZGJATJEN E KONKURSIT

Konkursi i publikuar në të përditshmen **EPOKA E RE** me datë **19.Prill 2019**, nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, për pozitën – **Zyrtar për Arkiv AK2/160 – 4 (katër ekzekutues ) për në Arkivin Nder komunal në Ferizaj**, për shkak të mos aritjes së pranimit të një numri të balancuar nga aspekti etnik, **zgjatet edhe për 7 (shtatë) ditë** duke filluar nga dita e publikimit në të përditshmen e cekur më lartë. Zgjatja e Konkursit bëhet, duke u bazuar në nenin 22 pika 3 e Rregullores nr.02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.  
 KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
 ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

### FTESË PËR OFERTË

Procedure e shitjes në bazë të rregullores së KRPP-së - Rregullat mbi Qeverisjen e Shitjes dhe Vendosjen e Aseteve, datë 24 Janar 2012, dhe Rregullat e Përgjithshme të Tenderimit në KEK, për Shitje të Aseteve të Luajtshme, datë 15 Shtator 2009

**SHITJA E QYMYRIT**  
**Rishpallje**  
**Procedure e Shitjes**  
**Nr. KEK-SHQ -19-001-811**

Korporata Energjetike e Kosovës sh. a. (KEK), me këtë rast, fton të gjithë blerësit e interesuar të dorëzojnë dokumentet e tenderimit.

Metoda që do të përdoret -shitja përmes ofertave publike të mbyllura për sasinë **250,000 t**

Blerësi fitues do të marrë qymyrin me pajisje disokontinuale në minierën e Sibovcit Jugperndimor, duke përdorur pajisjet vetjake – për përdorim vetjak apo për shitje të mëtutjeshme.

Ky aktivitet do të zhvillohet me procedurë të hapur me një zarf

Vizita në Vendndodhje : **20.05.2019** prej orës **10.00**- KEK , Divizioni i Prodhimit të Qymyrit,

Drejtoria Hyrja 01, Kastriot - e dëshirueshme

KEK fton të gjithë blerësit e interesuar të dorëzojnë ofertat e tyre me se voni me datë **27.05.2019** në ora **13.00**, ndërsa hapja e ofertave në ora **13:30**.

Kërkesat për tërheqjen e dosjes së tenderit drejtohen në adresat vijuese:

Email: [emin.tmava@kek-energy.com](mailto:emin.tmava@kek-energy.com) ose [minator.ferizi@kek-energy.com](mailto:minator.ferizi@kek-energy.com)

[www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



**KOMUNA JUNIK**  
 Dt.08.05.2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, neni 17, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës nenet 7 dhe 8, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr 04/L-032, Udhëzimit Administrativ të MASIT-it nr 10/2018, për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ të MPMS - nr 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Junikut shpallë :

### KONKURS

Për plotësim të vendit të lirë të punës për vitin shkollor 2018/2019

**Shkolla fillore e mesme e ulët “Edmond Hoxha” në Junik**

Një (1) mësimdhënës/c për lëndën Biologji-Kimi 20 orë në javë.

#### KUSHTET:

- Për vendin e lirë të punës për mësimdhënës/e kërkohet përgatitja profesionale përkatëse,
- Në mungesë të kuadrit të kualifikuar vijonë në konsiderim kandidatët me kualifikim të përafërt.

#### DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:

- Diploma (çertifikata) në origjinal ose fotokopje e vërtetuar nga organi përkatës,
- Çertifikata e lindjes,
- Letërnjoftimi i fotokopjuar,
- Dëshmi për përvojën e punës,
- Dëshmi për trajnimet arsimore,
- Çertifikata e shtetësisë,
- Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetim,
- Vërtetim nga zyra e Punësisimit.
- Aplikacioni tërhiqet dhe dorëzohet në Zyrën e pritjes në Junik,
- Dokumentacioni i pakompletuar si dhe ato pas afatit nuk merren në shqyrtim,
- Afati i konkurimit është 15 ditë nga data e shpalljes në gazetën ditore,
- Për ditën e intervistimit, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes telefonit.

#### Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: “Naim Frashëri”

Komuna: **Glllogoc**

Data: **08.05.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/010- ESIP/SDG/010-G/1.2	Blerja e mjeteve të teknologjisë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU “Naim Frashëri” Glllogoc, Glllogoc. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

#### 1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Laptop 3 Copë
- Miksetë 1 Copë
- Altoparlante 2 Copë
- Shtyllambajtëse 2 Copë
- Mikrofon 2 Copë

#### 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

#### 3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU “Naim Frashëri” Glllogoc, më së largu deri më **17.05.2019**

#### 4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur **Ftesë për ofertë-Mallra**, do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**

**Personi kontaktues:**

**Shkurte Dvorani**

**Telefoni: 044-362-514**

**E-maili: shkurte.dvorani@hotmail.com**





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

